



ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

RAPORTI VJETOR 2017



**„Nuk ka forcë që mund të jetë më e fuqishme se forca e ligjit“
Marcus Tullius Cicero**

PËRMBAJTJA



15

Standarte të revizionit dhe metodologjisë

29

Furnizime publike

9

Buxheti i ESHR

16

Bashkëpunimi me organet kompetente

30

Mendimet e revizionit

6

Fjalim hyrës nga zëvendës revizori i përgjithshëm

10

Shpenzime në vitin 2017

17

Teknologjia informatike dhe IT revizioni

35

Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë



12

Struktura e të punësuarve

19

Aktivitete të revizionit përmes numrave në vitin 2017



8

Misioni dhe Pavarësia

13

Dokumente strategjike

26

Konstatime të përfshira në revizion

42

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

43

Këshilli i inspektimit

50

Institucionet shëndetsore publike,
harmonizimi i punës e vërteta
dhe objektiviteti i raporteve
financiare



44

Arkivi shtetëror i
Republikës së Maqedonisë

52

Operatori i sistemit
elektro-përçues i
Republikës së Maqedonisë
S.H.A. "Mepso"

45

Partitë politike

54

Vetëqeverisja lokale

65

Ministria e vetëqeverisjes
lokale

85

Bashkëpunimi ndërkombtar

46

Zgjedhjet e parakohshme
parlamentare 2016

59

Ndërmarrjet publike në nivel
lokal

66

Revizioni i përpueshmërisë

92

Transparenca

49

Komisioni i letrave me vlerë

62

Ministria e kulturës

75

Revizioni i performancave

94

Raporti i revizorit të pavarur

6 Të nderuar,



Ju prezantoj Raportin vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2017, në të cilin në mënyrë përmbledhëse i shfaq rezultatet e punës sonë dhe gjendjet e konstatuara tek subjektet të cilat ishin lëndë e revizionit.

Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2017 ka realizuar programin e punës i cili i përfshiu të gjitha llojet e revizionit që në vazhdimësi tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë tërhequr vëmendjen për harxhimin e mjeteve buxhetore.

Me programin e punës u rumbullakua edhe realizimi i Strategjisë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2013-2017, i drejtuar kah maksimizimi i kontributit tonë në përforsimin e kontrollin financiar dhe përgjegjësisë në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë.

Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2017, ka publikuar 89 raporte, duke përfshirë edhe 183 subjekte të revizionit nga

kompetenca jonë. Raportet përmbajnë informata të rëndësishme dhe një numër të madh të rekomandimeve të cilat janë të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe harxhimin me përgjegjësi të mjeteve publike nga ana e subjekteve të revizionit. Gjatë zgjedhjes dhe definimit të përfshirjes së revizionit, u bazuam nga parimi i transparencës dhe harxhimit me dedikim të mjeteve dhe të kualitetit të shërbimeve të cilat i meritojnë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Ngritja profesionale e të punësuarve është realizuar përmes trajnimeve nga sfera e revizionit dhe shfrytëzimi i sistemit të ri për menaxhim me revizionet (Audit Management System). Trajnime interne, pjesëmarrjet e shumta në seminare ndërkombëtare, punëtori dhe në revizione kooperative me ISR gjatë vitit 2017 kanë kontribuar për ngritjen e nivelit profesional për të punësuarit dhe përkushtimin e tyre në realizimin e qëllimeve dhe detyrave tona programore. Të gjithë atyre singërisht u uroj!

Në planin ndërkombëtar, krahas aktiviteteve të rregullta dhe revizioneve kooperative në të cilat mori pjesë Enti Shtetëror i Revizionit, duhet theksuar edhe rrjetëzimin e grupeve të reja të punës. Fundi i vitit 2017 ishte në shenjë të përfundimit të aktiviteteve të projektit të Entit Shtetëror të Revizionit me Zyrën e Kryerevizorit të Norvegjisë të drejtuar në përmirësimin e efikasitetit dhe kualitetit të revizionit me zbatimin e sistemit për menaxhim me revizionin (Audit Management System - AMS) dhe fillimin e projektit të ri për përforsimin e mëtejme të kapaciteteve të ESHR (2017-2019) të financuar nga Bashkimi Evropian.

Rregullimi i kushtetutshmërisë së Entit Shtetëror të Revizionit dhe vendosja e mekanizimit të rregullt dhe efektiv për shqyrtimin e raporteve të revizionit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, sipas shembullit të praktikës evropiane, janë prioritete tona afatgjate dhe dëshirojmë të realizohen sa më shpejtë. Kjo do të mundësojë që raportet e revizionit të marrin vëmendjen e merituar në Kuvend, ndërsa ata që disponojnë me mjetet e qytetarëve do të thirren për harxhimin e tyre. Në fund dëshirojmë të rikujtoj faktin se në vitin 2017 Enti Shtetëror i Revizionit ka mbushur 20 vjet punë nga themelimi kur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë u miratua ligji i parë për revizionin shtetëror (1997).

Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor është edhe mendimi i revizorit të jashtëm dhe të pavarur për raportet financiare të Entit Shtetëror të Revizionit, për vitin 2017.

Zëvendës i revizorit kryesor shtetëror

Naser Ademi



Misioni

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është institucion i rëndësishëm i revizionit në Republikën e Maqedonisë, që ka për qëllim informimin në kohë dhe objektiv të Kuvendit, Qeverisë dhe bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe opinionit për konstatimet e revizionit nga revizionet e realizuara.

Enti Shtetëror i Revizionit siguron përkrahje të Kuvendit të RM-së në plotësimin e kompetencave të tij përmes identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të punës së kundërligjshme, dhe raste të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit.

Përmes rekomandimeve të qarta dhe efektive ESHR siguron përkrahje të institucioneve shtetërore të mjeteve publike për avancimin e menaxhimit me të njëjtat. Në këtë mënyrë ESHR kontribuon për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Pavarësia

Si revizor i jashtë dhe i pavarur ESHR kryen revizion në të hyrat publike dhe shpenzimet publike në pajtim me standardet e revizionit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI).


Pavarësia e ESHR është e garantuar me Ligjin për revizion shtetëror, i cili për herë të parë është miratuar në vitin 1997 dhe gjatë viteve është ndryshuar dhe plotësuar më shumë herë. Në vitin 2010 është miratuar Ligji i ri për revizion shtetëror i cili paraqet harmonizimin e mëtejshëm me deklaratën e Meksikës për pavarësinë e institucioneve supreme të revizionit dhe parimet bazë të Deklaratës së Limës për rregullat dhe drejtimit e revizionit. Me këtë ligj rregullohet pozicioni i ESHR dhe ligji i jep ESHR mandat të gjerë që të kryejë revizion të mbarëvajtjes dhe performancave, me qasje në të gjitha informatat e nevojshme. ESHR ka pavarësi financiare dhe autorizim të menaxhojë me resurset personale. ESHR ka liri të vendos për lëndët dhe përmbajtjen e revizioneve dhe të ketë mekanizëm të mjaftueshëm për përcjelljen e rekomandimeve, që të sigurohet se subjektet përkatëse i kanë implementuar rekomandimet e dhëna në raportet e revizionit.

Buxheti i entit shtetëror të revizionit


Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror (Gazeta Zyrtare nr. 66/10, 145/10, 158/11, 43/14, 154/15, 192/15, 127/2016) financimi i Entit Shtetëror të Revizionit sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Mjetet e nevojshme për punë me propozim të Entit Shtetëror të Revizionit i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Buxheti i plotë i miratuar për Entin Shtetëror të Revizionit në vitin 2017 arrinte 94.822.000,00 denarë. Prej tyre, 90.822.000,00 denarë ose 96% janë mjete të siguruar nga buxheti qendror, ndërsa të tjerat 4.000.000,00 denarë ose 4% janë të hyra personale. Burimet personale të mjeteve të shfaqura në llogarinë, të hyrat e paguara nga organet rrjedhin nga mjetet e paguara për revizionet e kryera të subjekteve, që Enti Shtetëror i Revizionit i ka kryer para miratimit të Ligjit të ri për revizionin shtetëror të miratuar në vitin 2010. Sipas ligjit prej vitit 2010, mjetet për punën e Entit Shtetëror të Revizionit janë siguruar në tërësi nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Mjete të miratuara nga Buxheti i RM-së sipas viteve



Shpenzime në vitin 2017




Nga aspekti i strukturës së shpenzimeve të Entit Shtetëror të Revizionit, 80% janë të dedikuara për rrogat e të punësuarve, 5% për kryerjen e revizionit në territorin e Republikës së Maqedonisë, 5% për shpërbime komunale, 8% për shpenzime tjera administrative dhe 2% janë shpenzime kapitale.

Gjatë vitit 2017 në Entin Shtetëror të Revizionit, paralelisht me revizionet janë zhvilluar aktivitetet e planifikuara me projektin MAK - 12/0015, „Zbatimi i sistemit për menaxhim me revizionin“. Projekti është financuar me mjete të donacionit të miratuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Buxheti i miratuar në vitin 2017 për realizimin e aktiviteteve të planifikuara me këtë projekt arrin 9.775.000,00 denarë. Mjetet e planifikuara ishin plotësisht të realizuara për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e qëllimeve të projektit: përmirësimi i efikasitetit dhe kualitetit të punës së revizionit me zbatimin e sistemit për menaxhimin e revizionit. Përfundimisht me 31.12.2017 me sukses përfundoi realizimi i Projektit.

Nga mjetet e plota, 18% kishin të bëjnë me shpenzime e dedikuara për trajnime dhe ngritje të njohurive dhe shkathtësive të revizorëve për zbatimin e sistemit të ri për menaxhim me revizionin, 38% për shpenzime tjera administrative dhe 2% për shërbime komunale.

Pjesa më e madhe, 42% nga shpenzime e plota, ishin të dedikuara për shpenzime kapitale. Prej tyre 75% ishin të dedikuara për furnizimin e zgjidhjeve softuerike për sistemin e menaxhimit të revizionit (faza e III-të), softuer për evidencë të IT incidenteve dhe softuer për përpunimin e video materialeve, audio dhe atyre grafike.

Mjetet tjera financiare ishin të dedikuara për furnizimin e përkrahjes së domosdoshme teknike dhe ngritjen e IT infrastrukturës në Entin Shtetëror të Revizionit i cili do të mundësojë zbatim të softuerit të ri për menaxhim me revizionin.



Gjatë vitit 2017 punën e revizionit shtetëror e kryejnë 89 të punësuar, revizorë shtetëror të autorizuar, revizorë shtetëror dhe të punësuar në sektorët për përkrahje administrative.

Organizimi i brendshëm i Entit Shtetëror të Revizionit është i organizuar në 3 (tre) sektorë të cilët direkt janë të përfshirë në procesin e revizionit (sektorë të revizionit) dhe mbulojnë sfera të ndryshme të sektorit publik, 1 (një) sektor për avancimin e revizionit dhe përcjelljen e praktikës ndërkombëtare për zbatimin e standardeve ndërkombëtare, 1 (një) sektor për revizionin e sistemeve të informacionit dhe 2 (dy) sektorë (punë juridike dhe çështje financiare) për përkrahje administrative. Gjithashtu në kuadër të organizatës funksionojnë edhe 2 /dy/ seksione, për resurse njerëzore dhe revizion i brendshëm.

Revizionin e kryejnë 79 revizorë, ndërsa 68 të punësuar posedojnë certifikatë për revizor të autorizuar shtetëror.

Nga numri i plotë i të punësuarve 99% janë me arsim universitar nga sfera e ekonomisë, shkencave juridike, teknologjisë informatike, ndërsa në vazhdimësi është duke u rritur edhe përqindja e të punësuarve të cilët kanë arritur shkallën akademike të magjistraturës.

Edukimi i të punësuarve në ESHR

Në pajtim me përcaktimet strategjike të ESHR dhe Programit vjetor të punës për vitin 2017, vazhdoi ngritja e vazhdueshme profesionale dhe aftësimi profesional i revizorëve dhe kuadrit udhëheqës në këtë institucion, që kontribuon për vendosjen e sistemit objektiv për vlerësimin e shkallës së kualitetit gjatë plotësimit të detyrave të punës.

Trajnimi i të punësuarve bëhet përmes më shumë formave: organizimi i trajnimeve të brendshme në kuadër të institucionit, me ligjërues prej të punësuarve dhe ekspertë të jashtëm, trajnim në vendin e punës, pjesëmarrje në kurse, seminare, punëtori, të organizuar nga grupe të punës/ komitete të INTOSAI dhe EUROSAI, Gjykatës Evropiane të Revizionit, SIGMA dhe organizata dhe asociacione të tjera profesionale ndërkombëtare.

Në vitin 2017 trajnimet e brendshme në ESHR janë realizuar në sferën e përdorimit të sistemit për menaxhim me revizionet (AMS) dhe për shkëmbimin e përvojave me pjesëmarrje të auditimeve kooperative të preformancave.

Realizimi i qëllimeve të përcaktuar në Strategjinë për zhvillim në ESHR 2013-2017 sigurojnë përparim të vazhdueshëm në punën e ESHR, zhvillim dhe përmirësim të kualitetit të revizioneve të kryera dhe përcjellje të efekteve nga revizionet e kryera, përparim në sistemin për menaxhim me kapacitetet institucionale të ESHR, si dhe qëllime tjera të përcaktuara me Strategjinë.

Përfundimisht me tetorin e vitit 2017 janë ndërmarrë një numër i madh i aktiviteteve për realizimin e qëllimeve strategjike nga aspekti i:

- Sigurimit të kualitetit të revizionit, që si procedurë e vlerësimit të funksionimit të kontrolleve të kualitetit, zbatohet në mënyrë të përcaktuar në udhëzimin e sigurimit të kualitetit të revizioneve. Me sigurimin e kryer të kualitetit në vitin 2017, ekipi i pavarur për kontroll dha vlerësim dhe drejtime që të sigurohet zbatim i rregullt i akteve metodologjike dhe praktikës së mirë në revizione;
- Tejkalmi i dobësive sistematike të përcaktuara në raportet e revizorëve, me sugjerimin e dobësive të identifikuara sistematike në çdo raport të revizionit veçmas, si dhe shfaqjen e tyre përmbledhëse në raportin vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2016;
- Fillimi i zbatimit praktik të sistemit elektronik për menaxhim me procese të revizionit (AMS), në bashkëpunim me Zyrën e revizorit kryesor të Norvegjisë (OAGN);
- Përparimin e sistemit ekzistues për menaxhim financiar dhe kontroll të Entit Shtetëror të Revizionit, në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontroll të brendshëm dhe Ligjit për kontroll të brendshëm financiar, përmes miratimit dhe zbatimit të më shumë procedurave për procese të rëndësime;
- Kryerja e funksionit të revizionit të brendshëm në ESHR dhe zbatimi i Planit për kryerjen e revizionit të brendshëm për vitin 2017;
- Enti Shtetëror i Revizionit si anëtar në mënyrë aktive merr pjesë në aktivitetet e EUROSAI Grupi i punës për etikë dhe revizion dhe në këtë drejtim ka realizuar kontakte me ISR në Hungari me qëllim të ndarjes së përvojave dhe shqyrtimit të mundësive për zbatimin e hulumtimit të integritetit në drejtim të sigurimit të kontributeve drejt preventivës së korrupsionit në subjektet e sektorit publik;
- Aktivitetet tjera për realizimin e qëllimeve strategjike lidhur me edukimin e të punësuarave, zbatimin e standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit në aktet metodologjike dhe praktika e revizionit shtetëror, bashkëpunimi me organet kompetente dhe organet e bashkëpunimit ndërkombëtar, janë arsyetuar në kapitujt përkatës të këtij raporti vjetor.

Lidhur me qëllimet strategjike të cilat duhet të realizohen në periudhën e ardhshme, Enti Shtetëror i revizionit ka filluar me realizimin e „Twining“ projektit IPA 2013 „Përforcimi i mëtejme i kapaciteteve dhe efikasiteti i Entit Shtetëror të Revizionit për kryerjen e revizionit të jashtëm“, i cili do të realizohet në afat prej dy viteve, përkatësisht përfundimisht me shtatorin e vitit 2019, në bashkëpunim me „twining“ partnerët: ISR-në e Bullgarisë dhe ISR-në e Kroacisë. Si rezultate të projektit, janë planifikuar më shumë aktivitete lidhur me përmirësimin e akteve metodologjike për revizion, avancimin e kapaciteteve për zbatimin e revizionit të rregullsisë dhe auditimit të preformancave, në veçanti në sferat e fondeve të BE-së, IT revizionet, furnizime publike dhe kontrollin publik të brendshëm financiar, si dhe rekomandimet për avancimin e mëtejme të procesit të bashkëpunimit me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Në pajtim me qëllimet e përcaktuara në Strategjinë për menaxhim me resurse njerëzore të ESHR, gjatë vitit 2017 është siguruar përsosmëri e vazhdueshme profesionale dhe trajnim për të punësuarit që mundëson kualitet të lartë në realizimin e revizioneve dhe sferave të ndryshme të punës.

Realizimi i IT Strategjisë të Entit Shtetëror të Revizionit 2013-2017 gjatë vitit 2017 ka vazhduar përmes ngritjes së vazhdueshme të sistemit informativ të Entit Shtetëror të Revizionit, në pajtim me zhvillimin e teknologjive të reja dhe standardeve. Gjithashtu, u realizua trajnimi për administratën dhe mirëmbajtjen e sistemit të informatikës, si dhe trajnimi për të punësuarit për shfrytëzimin e sistemit të ri për menaxhim me revizionet (AMS). Në bazë të dokumenteve për politika të sigurisë në IT sistemin e ESHR, në vitin 2017 u përgatitën dhe u miratuan IT procedurat dhe procedurat për zbatimin e AMS.

Në dhjetor 2017 u miratua Strategjia për zhvillimin e ESHR 2018-2022, e cila paraqet vazhdimësinë e strategjisë paraprake, me të cilën Enti Shtetëror i Revizionit vazhdon të hapërojë në rrugën e njëjtë dhe në mënyrë strategjike të zhvillohet duke u mbështetur në shtyllat mbajtëse të shndërruara në qëllime strategjike, me të cilën sigurohet vazhdimësi më e madhe e aktiviteteve të shumta dhe janë planifikuar aktivitete të reja, të cilat do të mundësojnë avancimin e mëtejme të Entit Shtetëror të Revizionit dhe punës së tij.

Dokumentet strategjike të organizatave ndërkombëtare të INTOSAI dhe EUROSAI ishin pikë fillestare për Strategjinë e zhvillimit të Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën e ardhshme pesëvjeçare, në të njëjtën janë shndërruar angazhimet për promovimin e përmirësimit të zbatimit të Standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit (ISSAI), për përforcimin e pavarësisë dhe integritetit si parakusht për realizimin e profesionalizmit dhe kredibilitetit në punë, si dhe për përcjelljen e vazhdueshme të efekteve nga revizionet e kryera nga ana e subjekteve të revizionit.

Gjithashtu, në dhjetor 2017 u miratua IT Strategjia e Entit Shtetëror të Revizionit për revizionin 2018-2022, e cila ka për qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit informativ të Entit Shtetëror të Revizionit) dhe njëherit të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2018-2022.

Përpilimi i IT Strategjisë bazohet në evoluimin e kryer të IT Strategjisë paraprake 2013-2017 dhe analizat e qëllimeve të realizuara dhe aktiviteteve të zbatuara, si dhe rezultatet e IT vetëvlerësimit në bashkëpunim me Gjykatën Holandeze të Revizionit si dhe zhvillimin teknologjik. Qëllimi i IT Strategjisë është mundësimi i zhvillimit të vazhdueshëm dhe i qëndrueshmërisë së IT kapaciteteve dhe sistemit të informacionit, me të cilën do të mundësohej dhënia e përkrahjes së vazhdueshme dhe kualitative nga puna e ESHR me shfrytëzimin e IT mjeteve dhe përkrahjes në procesin e IT revizionit, ndërsa përmes kësaj arritja e qëllimeve strategjike në ESHR.

Standarde të revizionit dhe metodologjia

Enti Shtetëror i Revizionit, në kuadër të kompetencave të veta ligjore, me sukses e realizon programin vjetor për punën e ESHR për vitin 2017, në pajtim me të cilën janë planifikuar 58 revizione prej të cilave 49 janë revizione të rregullsisë (revizione të raporteve financiare dhe revizione të harmonizimit), 4 janë revizione të performancave dhe 5 janë revizione të harmonizimit. Zgjedhja e subjekteve, projekteve dhe temave për Programin është kryer në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror dhe udhëzimin për propozimin e revizioneve për programin vjetor për punën e ESHR.

Me revizionet e performancave janë përfshirë tema me domethënie për qytetarët e Republikës së Maqedonisë siç janë kualiteti i ajrit, mbrojtja e pyjeve, efikasiteti i sistemit për furnizime publike, stabilitet financiar dhe partneritet publiko privat tek njësitë e vetëqeverisjes lokale. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit (ISSAI) në aktet metodologjike të ESHR-së, mundëson zhvillim të mëtejshëm të kualitetit të revizioneve.

Në përputhje me analizën e kryer për harmonizim me ISSAI standardet dhe Strategjinë për zbatimin e ISSAI standardeve, në vitin 2017 vazhdoi zbatimi praktik i revizionit të rregullsisë dhe revizionit të performancave, si dhe Doracaku i ri për përcjelljen e rekomandimeve, me të cilën sigurohet qasje e barazuar dhe kualitet i lartë gjatë revizionimit, si dhe mbulim metodologjik për përcjelljen e masave të ndërmarra sipas rekomandimeve në raportet e revizionit.

Në vitin 2017 filloi të zbatohet edhe Doracaku për revizionin IT, ndërsa zbatohen edhe doracakët për revizionin e rregullsisë dhe raporteve financiare të partive politike dhe për fushatat zgjedhore, të cilat janë përgatitur me qëllim që të jepet bazë metodologjike dhe drejtime për veprimin e revizorëve duke pasur parasysh nevojat specifike të këtyre revizioneve. Në vitin 2017 është përgatitur Doracak i ri për revizionin e njësitë të vetëqeverisjes lokale, me të cilën vazhdon harmonizimi i metodologjisë së akteve të ESHR-së me standardet ISSAI.

Bashkëpunimi me organet kompetente

Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë e dorëzon në shqyrtim Raportin vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2016.

Në vazhdimin e mbledhjes së gjashtë të mbajtur më 6 nëntor 2017, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shqyrtoi raportin vjetor për revizionet e kryera dhe punën e ESHR-së në vitin 2016 dhe miratoi konkluzione me të cilat konstaton se Enti Shtetëror i Revizionit gjatë vitit 2016 ka realizuar aktivitete në drejtim të kontributit të rritur në përforcimin e kontrollit financiar dhe përgjegjësisë në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë.

Gjithashtu, në konkluzionet Kuvendi konstaton edhe vlerësimin pozitiv të aktiviteteve të ESHR-së për kontrollet e kryera të rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit, si dhe nevoja që subjektet për revizionet të veprojnë sipas rekomandimeve të dhëna, në drejtim të përmirësimit të punës financiare dhe harxhimit të mjeteve publike me përgjegjësi.

Gjatë vitit 2017, në pajtim me obligimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Enti Shtetëror i Revizionit në Kuvendin e RM-së i ka dorëzuar të gjitha raportet përfundimtare të revizionit.

Bashkëpunimi i Entit Shtetëror të Revizionit me organet tjera kompetente vazhdoi edhe gjatë vitit 2017, ndërsa në kuadër të realizimit të Programit vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2017, në Prokurorinë Publike janë dorëzuar 8 (tetë) raporte të revizionit për 7 (shtatë) subjekte lëndë të revizionit, për të cilat revizori i autorizuar shtetëror ka vlerësuar se është kryer shkelje, vepër penale.

Enti Shtetëror i Revizionit në mënyrë aktive bashkëpunon me të gjitha organet shtetërore në drejtim të pengimit dhe zvogëlimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe ndeshjes së interesave. Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në realizimin e programit nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parapara në kapitullin 3.23. Jurisprudenca dhe të drejtat themelore, Sfera - Politika kundër korrupsionit dhe Kapitulli 3.32 Kontrolli financiar, Sfera - Revizioni i jashtë, si dhe puna e organeve të tjera dhe trupave për pengimin e korrupsionit.

Teknologjia informatike dhe IT revizioni

Enti Shtetëror i Revizionit e përkrah zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë informatike dhe përdorimin e tij racional dhe efikas në revizion.

Për këtë qëllim është siguruar funksioni i pandërprerë i infrastrukturës së sistemit të informacionit, si dhe sistemet e implementuar për ruajtjen e centralizuar dhe shkëmbimin e të dhënave për posta elektronike, sistemi për punë të arkivit, sistemi për informim të brendshëm për të punësuarit, sistemi i integruar financiar, sistemi i analizave të të dhënave nga raportet e revizionit dhe sistemet për menaxhim me procesin e revizionit (Audit Management System (AMS)). Sistemi dhe aplikacionet janë zhvilluar duke u përkujdesur për parimet dhe rregullat e: qasjes në të dhënat e shfrytëzuesit të autorizuar, besueshmërisë, integritetit, ruajtjen e siguritë të të dhënave në lokacionin qendror, harmonizimi me ligjet, kopjimin e rregullt rezervë (backup), mbrojtjen nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave.

Duke e përcjellë zhvillimin teknologjik, në vitin 2017 është zbatuar procedurë për furnizimin e pajisjeve informatike përmes IPA fondeve, zbatimi i të cilave është planifikuar në gjysmën e parë të vitit 2018. Furnizimi përfshinë laptop personal dhe desktop kompjuterë, serverë, monitorë dhe licenca për sisteme operative. Përpos këtyre mjeteve, përmes SEFP janë furnizuar edhe veglat softuerike: softuerë për evidencë të IT incidenteve dhe softuerë për përpunimin e materialeve video, audio dhe grafike.

Për realizimin pa pengesa të detyrave të revizionit, është siguruar edhe qasje në internet, si dhe në hapësirat e Entit Shtetëror të Revizionit, ashtu edhe gjatë punës në terren. Për ruajtjen digjitale të provave të revizionit përdoren skenerë përkatës, derisa qasja në sistemin informativ të ESHR-së nga rrjetet e jashtme është siguruar përmes kanaleve përkatëse (VNP). Revizorët shfrytëzojnë teknika ndihmëse të revizionit (CAAT's) në procesin e revizionit, si dhe IDEA softuer për analizën e të dhënave prej të cilave gjenerohen raportet financiare.

Në vitin 2017 është përgatitur dhe miratuar IT strategjia e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2018-2022. Gjithashtu, në pajtim me politikat e miratuara për sigurinë e sistemit informativ të Entit Shtetëror të Revizionit, janë miratuar edhe IT politikat e sigurisë pranë ESHR-së dhe IT procedurat për zbatimin e Sistemit për menaxhim me procesin e revizionit (AMS).

Në vitin 2017 me sukses përfundoi projekti „Përmirësimi i efikasitetit dhe kualitetit të punës së revizionit me përdorimin e sistemit për menaxhim me proceset e revizionit (Audit Management System (AMS))“, i financuar me grant të Mbretërisë së Norvegjisë dhe i realizuar me ndihmën teknike të Zyrës së kryerevizorit të Norvegjisë. Është vendosur sfera e testit, e cila shfrytëzohet për testimin e versioneve të reja të AMS-së, si dhe sfera e produksionit, e cila shfrytëzohet për përdorim nga ana e revizorëve. AMS është dizajnuar, testuar dhe zbatuar në pajtim me nevojat. I njëjti përbëhet nga më shumë module: moduli i planifikimit vjetor, moduli për kryerjen e procesit të revizionit, moduli për menaxhim me bazën e subjektit të

revizionit, moduli i shkëmbimit të informatave, moduli i diskutimit, moduli i mësimin, moduli i raporteve dhe moduli i administrimit. Në pajtim me aktivitetet e parapara revizionet e Programit vjetor për vitin 2017, duke filluar nga 01.03.2017, janë realizuar me përdorimin e AMS-së. Paraprakisht është organizuar trajnim për të punësuarit në Entin Shtetëror të Revizionit për përdorimin e AMS-së (për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit).

Revizioni i sistemeve informative është pjesë e revizionit të rregullsive, ku revizori e vlerëson përkushtimin dhe funksionalitetin e kontrolleve duke i përcaktuar rreziqet e specifikave tek kontrollet e brendshme me të cilat ballafaqohet subjekti i revizionit (qasje të autorizuar, ndryshim i autorizuar i të dhënave, humbje potenciale e të dhënave etj.) që të bindet të autenticitetin, integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave.

Sipas standardeve për revizion të cilat i zbaton Enti Shtetëror i Revizionit vlerësohen politikat dhe procedurat e IT rrethimit të subjektit të revizionit, me qëllim të sigurimit të bindjes se janë vendosur kontrolle përkatëse dhe mekanizma për zbatim.

Enti Shtetëror i Revizionit, me sugjerimet e revizionit për nevojën e miratimit të strategjisë për zhvillim të sistemeve informative, si dhe rregullimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë dhe procedurave për sistemet e përmirësimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, lidhshmëria e sistemit informativ dhe shkëmbimi i të dhënave, lidhshmëria e bazave të të dhënave tek aplikacionet e caktuara dhe kontrolli i qasjes në aplikacione.

Me rekomandimet e dhëna do të përmirësohet menaxhimi me IT resurset në pajtim me prioritetet për zhvillimin e subjektit të reviduar, gjithashtu do të zvogëlohet edhe rreziku nga mbrojtja joefikase e sistemit informativ, humbja ose dëmtimi i të dhënave, pasaktësia, shënimet jo autentike dhe qasje jo e autorizuar në të dhënat e sekrete.

Aktivite të revizionit përmes numrave në vitin 2017

89 RAPORTE TË PËRFUNDUARA

79 RAPORTE TË REVIZIONIT PËR REVIZIONIN E MBARËVAJTJES

6 RAPORTE TË REVIZIONIN PËR REVIZIONIN E PËRPUTHSHMËRISË

4 RAPORTE TË REVIZIONIN PËR REVIZIONIN E PERFORMANCAVE

183 SUBJEKTE TË REVIDUAR

1042 KONSTATIME TË REVIZIONIT

789 REKOMANDIME NË RAPORTET E REVIZIONIT

16 RAPORTE TË REVIZIONIT TË DORËZUAR NË PROKURORINË
PUBLIKE TË RM-SË

89 RAPORTE TË REVIZIONIT TË DORËZUARA NË KUVENDIN E RM-SË

258.840 MILIONË DENARË TË HYRA PUBLIKE TË REVIDUARA


106.671 MILIONË DENARË TË HYRA PUBLIKE TE REVIDUARA

Revizione të kryera dhe raporte të përfunduara


Në vitin 2017 janë kryer 58 revizioni (2016-45 revizione) prej të cilave 48 revizione të mbarëvajtjes, 6 (gjashtë) të përputhshmërisë, 4 revizione të performancave.

Nga revizionet e kryera janë lëshuar 89 raporte të revizionit (2016-85), prej të cilave 79 për revizionin e mbarëvajtjes, 6 raporte për revizionin e kryer të harmonizimit dhe 4 raporte për revizionin e performancave.

Pasyqrim i revizioneve të kryera dhe struktura e tyre				
Programi vjetor i ESHR	2017		2016	
Lloji i revizionit	Numri i revizioneve të kryera dhe struktura			
	Numri	Pjesëmarrje në %	Numri	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Revizioni financiar dhe revizioni i përputhshmërisë	48	83	36	80
Revizioni tematik/ revizioni i përputhshmërisë	6	10	2	5
Auditim i performancave /ZJVFK	0	0	1	2
Auditim i performancave	4	7	6	13
Gjithsej revizione të kryera	58	100	45	100



Pasqym i raporteve të përfunduara dhe struktura				
Programi vjetor i ESHR				
		2017		2016
Lloji i revizionit	Numri i raporteve të përfunduara dhe struktura			
	Numri	Pjesëmarrje në %	Numri	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Revizioni financiar dhe revizioni i përputhshmërisë	79	89	76	89
Revizioni tematik/ revizioni i përputhshmërisë	6	7	2	2
Auditim i performancave /ZJVFK	0	0	1	1
Auditim i performancave	4	4	6	8
Gjithsej revizione të kryera	89	100	85	100




Subjekte të përfshira në revizion

Enti Shtetëror i Revizionit me Planin vjetor të punës, dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara për zgjedhjen e subjekteve dhe tema të revizionit, i definon subjektet dhe sferat të cilat do të revidohen në nivel vjetor.

Përfshirja e revizionit shtetëror nga aspekti i numrit të subjekteve të reviduara, i përfshinë edhe subjektet të cilat detyrimisht janë të reviduara çdo vit, në pajtim me ligjin.

Për arritjen e qëllimeve për revizionet e kryera, varësisht nga ajo se nëse revizioni i kryer i mbarëvajtjes ose revizioni i performancave, gjatë vitit 2017, me revizionin janë përfshirë 183 subjekte nga të gjitha revizionet e kryera. Në pasqyrimin vijues është dhënë struktura e subjekteve të përfshira me revizionin, sipas llojit të revizionit:


Pasqyrim i subjekteve të reviduara dhe subjekteve të përfshira me auditimin e performancave				
		2017		2016
Lloji i revizionit	Subjekti	Pjesëmarrje në %	Subjekti	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Revizioni financiar dhe revizioni i përputhshmërisë	48	26	36	31
Revizioni tematik/ revizioni i përputhshmërisë	22	12	9	8
Auditim i performancave /ZJVFK	0	0	1	1
Auditim i performancave	113	62	72	60
Gjithsej subjektet e përfshira në PV	183	100	118	100



Kontrolle për zbatimin e rekomandimeve

Në vitin 2017 Enti Shtetëror i Revizionit për revizionin ka kryer kontrolle për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up) të lëshuara në vitin 2016 dhe 2017, në funksion të përcaktimit të shkallës së zbatimit të tyre. Në tabelën më poshtë është dhënë numri i kontrolleve „follow up“ të kryera dhe raportet e lëshuara për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit.

Pasqyrim i kontrolleve të kryera follow-up			
Revizioni i zbatimit të rekomandimeve	2017	2016	Gjithsej
1	2	3	4
Numri i kontrolleve të kryera follow-up për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në RV	8	26	34
Numri i raporteve të përfunduara sipas follow-up kontrolleve për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në RV	13	40	53




Të hyra publike të reviduara

Shuma e plotë e të hyrave të reviduar publike me revizionet e kryer të raporteve financiare në vitin 2017, janë të shfaqura në pasqyrimin si vijon:

Pasqyrimi i të hyrave publike të reviduara (në milionë denarë)				
Të hyra publike të reviduara në:	2017		2016	
	Të hyra	Pjesëmarrje në %	Të hyra	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Buxheti Qendror i R.Maqedonisë	156.315	61	156.493	63
Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale	5.244	2	2.679	1
Buxheti i fondeve	89260	34	84993	34
Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH (IPSH - spitale, klinika...)	1510	1	955	0
Partitë politike	598	0	232	0
Ndërmarrjet publike	640	0	6166	2
Institucione tjera	5273	2	118	0
Gjithsej	258.840	100	251.636	100


Në strukturën e të hyrave publike të reviduar në vitin 2017, sipas llogarive vjetore për vitin 2016, të hyrat e Buxhetit Qendror të Republikës së Maqedonisë marrin pjesë me 61% në të hyrat e plota të reviduara, buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale me 2%, buxhetet e fondeve marrin pjesë me 34%, shfrytëzuesit e mjeteve të buxhetit të FSSH (ISHP spitale, klinika...) me 1% dhe të hyrat e reviduara të institucioneve të tjera marrin pjesë me 2% në të hyrat e plota të reviduara.



Shpenzime publike të reviduara

Në strukturën e shpenzimeve të reviduar publike në vitin 2017, sipas llogarive vjetore për vitin 2016, shpenzimet e shfrytëzuesve të Buxhetit Qendror arrijnë 4% në shpenzimet e plota të reviduar, shpenzimet e reviduar të njësive të vetëqeverisjes lokale marrin pjesë me 5%, shpenzimet e reviduar të buxheteve të fondeve marrin pjesë me 84%, shfrytëzuesit e mjeteve të FSSH (spitale dhe klinika...) marrin pjesë me 1%, shpenzimet e ndërmarrjeve publike marrin pjesë me 1% dhe 5% nga shpenzimet e reviduar kanë të bëjnë me institucione tjera.

Pasqyrimi i të hyrave të reviduara publike (në milionë denarë)				
Të hyra publike të reviduara në:	2017		2016	
	Shpenzime	Pjesëmarrje në %	Shpenzime	Pjesëmarrje në %
1	2	3	4	5
Buxheti qendror i R.Maqedonisë	4.668	4	18.461	17
Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale	4.955	5	2.400	2
Buxheti i fondeve	89.260	84	83.017	77
Shfrytëzuesit e mjeteve të buxhetit të FSSH (IPSH - spitale, klinika...)	1.497	1	951	1
Partitë politike	598	0	217	0
Ndërmarrje publike	629	1	3.306	3
Institucione të tjera	5.064	5	138	0
Gjithsej	106.671	100	108.490	100



Shpenzime të reviduara sipas llojit të buxhetit në raport me buxhetet e plota

	(në milionë denarë)			(në milionë denarë)			
	Buxheti i realizuar për vitin 2016	Reviduar	Pjesëmarrje në %	Buxhet i realizuar për 2015	Reviduar	Pjesëmarrje në %	
	1	2	3	4 (3/2)	5	6	7 (6/5)
Shfrytëzues dhe njësi shfrytëzuese në Buxhetin qendror (G.Zyrtare e RM-së 92/24.07.2017)	154.777	12.456	8	160.390	23.073	14	
Buxheti i njësisve të vetëqeverisjes lokale	30.493	4.955	16	29.251	2.400	8	
Buxheti i fondeve	89.260	89.260	100	83.017	83.017	100	
GJITHSEJ	274.530	106.671	39	272.658	108.490	40	

Konstatime të revizionit/ gjendje të konstatuara

Gjatë zbatimit të Programit vjetor për punën e vitit 2016 revizorët e autorizuar shtetëror dhe revizorët shtetëror në raportet e revizionit kanë konstatuar 795 konstatime/ gjendje gjatë kryerjes së revizionit shtetëror si vijojnë:

- 25 konstatime të Buxhetit Themelor;
- 893 konstatime me revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e përputhshmërisë;
- 124 konstatime revizionin e performancave;

Në pasqyrimet më poshtë është shfaqur pjesëmarrja e konstatimeve sipas sferave/temave dhe llojeve të revizionit.

1. Revizioni i përputhshmërisë në Buxhetin Themelor të RM-së

Lloji i konstatimit		Numri
1	2	3
1	Përgatitja e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë	1
2	Realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë	24
GJITHSEJ		25

2. Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i përputhshmërisë


Lloji i rezultatit		numri
1	2	3
1	Konstatime të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e regullativës ligjore dhe dispozitave	225
2	Konstatime të cilat kanë të bëjnë me raportet financiare	204
3	Konstatime në sistemin e kontrollit të brendshëm	39
4	Konstatime të cilat kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mjeteve në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat ligjore	57
5	Konstatime të cilat kanë të bëjnë me furnizime publike	63
GJITHSEJ		588
6	Theksim i çështjeve të papërcaktuar dhe kontinuitet	112
7	Çështje të tjera	186
8	Dobësi në sistem	7

3. Auditim i performancave

Konstatimi		Numri
1	2	3
1	Konstatime të revizionit të performancave, në pajtim me temën e revizionit	124
GJITHSEJ		124

REKAPITULAR I KONSTATIMEVE NË RAPORTET PËRFUNDIMTARE

Lloji i revizionit		Numri
1	2	3
1	Revizioni i përputhshmërisë së Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë	25
2	Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i përputhshmërisë	588
3	Revizioni i performancave	124
GJITHSEJ I		737
4	Theksimi i çështjeve të papërcaktuara dhe kontinuitet	112
5	Çështje të tjera	186
6	Dobësi të sistemit	7
GJITHSEJ II		305
GJITHSEJ I + II		1042



- Revizioni i përputhshmërisë së Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë
- Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i përputhshmërisë
- Revizioni i performancave

Furnizime publike

Gjatë vitit 2017 Enti Shtetëror i Revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të planifikuara, i revidonte edhe furnizime publike tek subjektet që janë lëndë e revizionit. Gjatë kontrollit në mënyrën e planifikimit, zbatimit dhe realizimit të furnizimeve publike, janë konstatuar 63 raste të cilat kanë të bëjnë me këto parregullsi, përkatësisht nën konstatime:

Nr. rend.	Lloji i nën konstatimit	Numri i nën konstatimeve
1	2	3
1.	Nuk janë zbatuar procedurat për furnizime publike/furnizim para lidhjes së kontratës për FP/ furnizime të kryera me kontrata të vjetra nga viti i kaluar	7
2.	Dobësi në fazën e planifikimit të FP/ (lloji i furnizimit, zgjedhje e procedurës përkatëse, sasi të planifikuara, dinamika, mjete të planifikuara financiare, dorëzimi i planit në AFP, ndryshimi dhe plotësimi i planit etj.)	8
3.	Dobësi në fazën e miratimit të vendimit për FP	7
4.	Dokumentacioni i tenderit i cili nuk i përmban elementet e përcaktuara me LFP	10
5.	Kriteret e përcaktuara për ndarjen e kontratës për FP të cilat janë në pajtim me LFP	7
6.	Dobësi gjatë evoluimit të ofertave	12
7.	Dobësi në fazën e lidhjes së marrëveshjes me ofertuesit e zgjedhur (nuk lidh kontratë me ofertuesin e zgjedhur; kontrata të lidhura me çmimet, kushtet dhe elementet tjera të ndryshme nga ofertat; nënshkrimi i kontratës në afat më të shkurtër sesa parashihet me ligj.)	12
8.	Dobësi në fazën e realizimit të kontratave të lidhura për FP (garanci, çmime, sasi, kushte të pagesës etj, kushte të ndryshme nga ato të definuara me kontratë)	16
9.	Procedura të pavendosura për përcjelljen e realizimit të kontratës në tërësi si nga aspekti kuantitativ dhe ai kualitativ	6
10.	Ndarjen e furnizimeve/anashkalimin e procedurave për FP të përcaktuar me ligj	5
11.	Dobësi të karakterit teknik gjatë përgatitjes së dokumentacionit/ dosjes për zbatimin e FP (evidence jo e rregullt dhe e jo e plote/ dosje, të nënshkruara/ shkresa jo plotësisht të nënshkruara/ raporte/ pasqyrime, gabime matematikore etj.)	5
12.	Dobësi në zbatimin e SVFP (të pa zbatuara, parregullsisht të zbatuara)	5

Mendimet e revizionit

Qëllimi kryesor në procesin e revizionit të mbarëvajtjes është t'i mundësojë revizorit të shpreh mendimin për atë nëse:

- raportet financiare me të vërtetë dhe objektivisht e shprehin gjendjen financiare dhe rezultatin e aktiviteteve financiare dhe
- aktivitetet, transaksionet financiare dhe informatat e reflektuara në raportet financiare janë në pajtim me rregullativën relevante ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Në pajtim me qëllimet e vendosura në raportet financiare, janë shprehur mendime për raportet financiare dhe për harmonizim me ligjin dhe dispozitat.

Në raportet e revizionit për raportet financiare për vitin 2016, janë shprehur:

- 21% - mendime pa rezervë (mendime pozitive);
- 27% - mendime pa rezervë;
- 40% - mendime negative dhe
- 12% - përmbajtje nga dhënia e mendimit.


Për harmonizime me ligjet dhe dispozitat: janë shprehur:

- 11% - mendime pa rezervë (mendime pozitive);
- 45% - mendime pa rezervë;
- 43% - mendime negative, dhe
- 1% - përmbajtje nga dhënia e mendimit.


Më poshtë është dhënë pasqyrim i mendimeve të shprehura me strukturën - raportet financiare dhe për harmonizimin me ligjet dhe dispozitat për vitin 2016, të përmbajtura në raportet e revizionit në vitin 2017.

Pasqyrim i mendimeve të shprehura për raportet financiare dhe harmonizim me dispozitat ligjore				
Programi vjetor për vitin 2017				
Mendimi i revizorit	Raporte financiare për vitin 2016		Harmonizim me ligjet dhe dispozitat për vitin 2016	
	Numri	Pjesëmarrje në %	Numri	Pjesëmarrje në %
Mendimi pa rezervë (pozitiv)	17	21	9	11
Mendimi me rezervë	21	27	37	45
Mendimi negativ	32	40	35	43
Përmbajtur lidhur me dhënien e mendimit	9	12	1	1
Gjithsej	79	100	82	100

Pasqyrim i mendimeve të shprehura për raportet financiare



Pasqyrim i mendimeve të shprehura për raportet financiare dispozita



Masa të ndërmarra sipas rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit

Krahas misionit kryesor të Entit Shtetëror të Revizionit si Institucion suprem i revizionit në kohë dhe objektivisht t'i informojë bartësit e funksioneve publike dhe opinionit për konstatimet e revizionit nga revizionet e realizuara, gjithashtu qëllimi i revizionit është të dërgojë rekomandime të qarta dhe efektive me të cilën ESHR siguron përkrahje të institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesve të mjeteve publike për avancimin dhe menaxhimin me të njëjtat.


Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i obliguar ta informojë Entin Shtetëror të Revizionit dhe organin kompetent për mbikëqyrje dhe kontroll, për masat e marra lidhur me konstatimet dhe rekomandimet në raportet e revizionit, në afat prej 90 ditësh nga pranimi i raportit përfundimtar.

Enti Shtetëror i Revizionit e përcjellë zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizionit të rregullt, në veçanti revizioni i veçantë dhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve, si dhe përmes informatave të pranuar nga subjektet. Pas revizioneve të kryera nga Programi vjetor për punën e ESHR për vitin 2016, janë dhënë gjithsej 670 rekomandime, ndërsa janë marrë për 431 rekomandim ose veprimi sipas rekomandimeve është 64%.

Pas revizioneve të kryera nga Programi vjetor për punën e ESHR për vitin 2017, Enti Shtetëror i Revizionit ka lëshuar 789 rekomandime. Deri në ditën e përpilimit të Raportit vjetor për vitin 2017, për 372 rekomandime të dhëna nuk ka skaduar afati ligjor për raportim lidhur me masat e ndërmarra. Nga gjithsej 417 rekomandime për të cilat afati për marrjen e reagimeve për zbatimin ka skaduar, 108 janë plotësisht ose pjesërisht të zbatuara, përkatësisht zbatimi është në rrjedhë, 27 rekomandime nuk zbatohen (të ndërlidhura me organe të tjera kompetente/faktorë të jashtëm, ose mos pajtime), për 282 rekomandime nuk është dorëzuar përgjigje, përkatësisht nga subjekti nuk ka pasur reagim për veprim sipas rekomandimeve.


Në pasqyrimin e ardhshëm janë dhënë të dhënat për kategoritë statusore të masa të marra sipas rekomandimeve të dhëna për vitin 2016 dhe 2017:

STATUS I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RP SIPAS PV 2016 DHE PV 2017			
PËR PROGRAMIN E VITIT 2016			
	PËRSHKRIMI	Për PV 2016	
		Numri	Pjesëmarrje në %
1	Rekomandime sipas të cilave është vepruar/ Rekomandime të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të zbatuara ose janë në rrjedhë	431	64
2	Rekomandime të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë marrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk pajtohet me rekomandimin e dhënë, është i lidhur me faktorë të jashtëm etj.)	124	19
3	Rekomandime të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara	16	2
4	Rekomandime për të cilat subjekti nuk ka dhënë informacion kthyes për masat e marra/ nuk janë bërë kontrolle/ revozori nuk ka pasur informacione të mjaftueshme që ta konfirmojë statusin e rekomandimit.	99	15
Numri i plotë i rekomandimeve për të cilat ka kaluar afati prej 90 ditësh për reagim		670	100
5	Rekomandime për të cilat afati prej 90 ditësh për dorëzimin e reagimit nuk është i ndryshuar	0	
GJITHSEJ REKOMANDIME TË DHËNA		670	



- Rekomandime sipas të cilave është vepruar/ Rekomandime të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të zbatuara ose janë në rrjedhë
- Rekomandime të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë marrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk pajtohet me rekomandimin e dhënë, është i lidhur me faktorë të jashtëm etj.)
- Rekomandime të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara
- Rekomandime për të cilat subjekti nuk ka dhënë informacion kthyes për masat e marra/ nuk janë bërë kontrolle/ revozori nuk ka pasur informacione të mjaftueshme që ta konfirmojë statusin e rekomandimit.

PËR PROGRAMIN VJETOR 2017			
PËRSHKRIMI	Për PV 2017		
	Numri	Pjesëmarrje në %	
1 Rekomandime sipas të cilave është vepruar/ Rekomandime të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të zbatuara ose janë në rrjedhë	108	26	
2 Rekomandime të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë marrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk pajtohet me rekomandimin e dhënë, lidhur me faktorë tjerë të jashtëm etj)	27	6	
3 Rekomandime të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara	0	0	
4 Rekomandime për të cilat ka kaluar afati ndërsa subjekti nuk ka reaguar për masat e ndërmarra/ revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme që ta përcaktojë statusin e rekomandimeve/ nuk janë kryer kontrolle	282	68	
Numri i plotë i rekomandimeve për të cilat ka kaluar afati prej 90 ditësh për reagim	417	100	
5 Rekomandime për të cilat afati prej 90 ditësh për dorëzimin e reagimit ka kaluar	372		
GJITHSEJ REKOMANDIME TË DHËNA	789		



- Rekomandime sipas të cilave është vepruar/ Rekomandime të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të zbatuara ose janë në rrjedhë
- Rekomandime të cilat nuk janë zbatuar (nuk janë marrë masa për shkak të faktorëve të jashtëm, subjekti nuk pajtohet me rekomandimin e dhënë, lidhur me faktorë tjerë të jashtëm etj)
- Rekomandime të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara
- Rekomandime për të cilat ka kaluar afati ndërsa subjekti nuk ka reaguar për masat e ndërmarra/ revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme që ta përcaktojë statusin e rekomandimeve/ nuk janë kryer kontrolle

Buxheti themelor i Republikës së Maqedonisë

Si instrument më i rëndësishëm i politikës ekonomike, Buxheti i Republikës së Maqedonisë i reflekton lëvizjet e pritura fiskale, të hyrat publike për financimin e politikave prioritare dhe qëllimeve, në drejtim të mbajtjes së rritjes ekonomike dhe mbrojtjes sociale. Në ç'rast, gjatë përcaktimit të Projektbuxhetit të Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave duke e zbatuar parimin e barazimit buxhetor, planifikimin e të hyrave kryen në shumën të cilat realisht mund të jenë të realizuara dhe për shpenzimet në shumën që nuk janë të domosdoshme për financimin e vëllimit përkatës dhe kualitetit për të mirat dhe shërbimet publike. Gjithashtu bën projektimin e deficitit si dallim negativ mes të hyrave të planifikuara përkatësisht të hyrave për pagesa dhe mjeteve të miratuara përkatësisht shpenzime dhe financimin e tyre. Gjatë planifikimit të Buxhetit, Ministria e Financave i përcakton burimet e financimit të deficitit edhe atë nga burimet e huaja - kreditë e institucioneve financiare ndërkombëtare, linjë kreditore të dedikuara për financimin e projekteve të ndara, euroobligacione dhe lloje të tjera të ngarkimeve me borxh nga vendet e huaja dhe nga burimet vendase - emisione të letrave shtetërore me vlerë.

Me revizionin e mbarëvajtjes së Buxhetit themelor, si plan vjetor i të hyrave, të hyrave të tjera dhe mjetet e miratuara me Buxhetin për financimin e kompetencave themelore të shfrytëzuesve buxhetor për vitin 2016, kemi zbatuar procedurën të revizionit me qëllim të marrjes së besimit të matur për atë nëse procesi i **planifikimit të Buxhetit themelor të Republikës së Maqedonisë** është i harmonizuar me planet strategjike të shfrytëzuesve buxhetor dhe politikat buxhetore, nëse të hyrat e realizuara, grumbullimet tjera dhe derdhjet tjera janë në kuadër të shumave të planifikuara, si dhe nëse procedurat e vendosura të kontrollit funksionojnë me efikasitet dhe rregull për pengimin ose zbulimin e gabimeve në IT sistemet e Drejtorisë Doganore të RM-së, Drejtorisë së të Hyrave Publike, si dhe Llogarisë së thesarit dhe evidenca.

Me analizën e bërë të afateve ligjore të përcaktuara, konstatojmë se miratimi i akteve, të cilat kanë të bëjnë me planifikimin e miratimit të Buxhetit për vitin 2016, shmang afatet e përcaktuara. Pikërisht edhe krahas përgatitjes dhe miratimit të vonuar të strategjisë financiare, Ministria e Financave cirkularin buxhetor për vitin 2016 e ka dorëzuar në ministritë dhe organet tjera të drejtorisë shtetërore në afatin e paraparë me ligj, në të cilat shumat maksimale të mjeteve të miratuara i ka përcaktuar në kuadër të shumave të përcaktuara maksimale të shpenzimeve të përcaktuara në nivelin e shfrytëzuesit buxhetor për vitin 2015, që krijon rrezik për mjetet e miratuara për shfrytëzuesit buxhetor të mos i reflektojnë nevojat e tyre reale për realizimin e aktiviteteve të planifikuara. Gjithashtu, e kemi shfaqur nevojën për përgatitjen dhe miratimin e planeve strategjike, si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore të përgatitura nga ana e disa organeve shtetërore.


Gjendjet e përmendura tregojnë nevojën e respektimit të afateve të përcaktuara për përgatitjen dhe miratimin e strategjisë fiskale si dhe nevojën e dorëzimit të kërkesave të plota buxhetore nga ana e shfrytëzuesve buxhetor, janë me qëllim që buxheti i miratuar të jetë në përputhje me nevojat reale të shfrytëzuesve për shkak të realizimit të qëllimeve të vendosura.

Realizimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë e reflekton politikën fiskale e cila është e realizuar në vitin e kaluar, shkallën e realizimit të politikave të përcaktuara dhe masat, jep pasqyrim të menaxhimit me mjetet financiare dhe shfrytëzimin e të njëjtave nga ana e shfrytëzuesve buxhetor.


Me zbatimin e teknikave revizore kemi kryer analiza për të dhënat e mara nga Regjistri kryesor i thesarit, për të dhënat e evidentuara në bazën e kontabilitetit për llogarinë e buxhetit themelor, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e plota dhe harxhimet të tjera si dhe të hyrat e plota dhe grumbullime të tjera.

Shpenzimet e plota dhe dalje të tjera në vitin 2016 janë kryer me shumë të plotë prej 139.320.440 mijë denarë që është për 5.280.477 mijë denarë ose 3,65% më pak se shuma e planifikuar. Pjesëmarrje në disa lloje të shpenzimeve dhe daljeve të tjera lidhur me numrin e plotë në Buxhetin themelor të RM-së për vitin 2016 është shfaqur në këtë grafion:

Struktura e shpenzimeve të Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016




Shpenzime të realizuara në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016



Të hyrat e planifikuara dhe grumbullimet tjera në Buxhetin themelor të Republikës së Maqedonisë janë bazë për përcaktimin e mjeteve të miratuara me buxhetin, për financimin e kompetencave të shfrytëzuesve buxhetor. Mënyra e pagimit dhe grumbullimi i të hyrave në llogarinë e Buxhetit themelor janë të rregulluara me Ligjin për buxhete, Ligji për realizmin e Buxhetit të RM-së dhe ligje të tjera dhe akte nën ligjore me të cilat përfshihen llojet e veçanta të të hyrave dhe dispozitave tjera.

Në Buxhetin themelor të RM-së për vitin 2016 janë planifikuar të hyra dhe grumbullime të tjera me shumë 144.600.918 mijë denarë, ndërsa janë realizuar me shumë të plotë prej 155.439.988 mijë denarë, që është për 7,5% më shumë se ajo e planifikuar, e ndarë sipas të hyrave dhe grumbullimeve të tjera në grafikonin më poshtë:


Të hyra e planifikuara dhe të realizuara në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016



Pjesëmarrja më e madhe në të hyrat e Buxhetit themelor të RM-së kanë **të hyrat tatimore** të cilat në vitin 2016 janë realizuar me shumë të plotë prej 97.336.145 mijë denarë dhe marrin pjesë me 62,6% në të hyrat e plota të Buxhetit themelor, derisa në vitin 2015 janë realizuar me shumë prej 90.641.223 mijë denarë dhe pjesëmarrje me 58%.

Pjesëmarrje në llojet më të ndara të të hyrave dhe grumbullimeve të tjera janë të shfaqura në këtë grafikon.

Struktura e të hyrave në Buxhetin Themelor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016



Drejtoria e të Hyrave Publike ka rol të rëndësishëm në sigurimin e të hyrave tatimore në Buxhetin e RM-së dhe atë pagimin e të hyrave nga tatimi personal i të hyrave, tatimi i vlerës së shtuar dhe tatimi mbi fitimin.

Në vitin 2016 të hyrat tatimore të realizuara nga ana e Drejtorisë për të Hyra Publike janë me shumë të plotë prej 92.575.405 mijë denarë dhe marrin pjesë me 95,11% në të hyrat e plota tatimore të Buxhetit themelor.

Pjesëmarrje më të madhe në të hyrat tatimore kanë të hyrat në bazë të tatimit të vlerës së shtuar me 47,2% të cilat në vitin 2016 janë realizuar me shumë të plotë prej 45.948.574 mijë denarë dhe akciza me 21,7% të cilat janë realizuar me shumë prej 21.094.123 mijë denarë.

Tatimi personal i të hyrave merr pjesë me 14,60% në të hyrat e plota tatimore. Në vitin 2016, u realizuan të hyra të plota me shumë prej 14.204.751 mijë denarë.

Tatimi i fitimit merr pjesë me 11,06% në të hyrat e plota tatimore, përkatësisht janë realizuar me shumë prej 10.768.674 mijë denarë.

Në kuadër të Drejtorisë për të Hyra Publike është vendosur edhe Sektori i shoqërisë informatike i cili duhet në formë elektronike t'i bashkojë funksionet e lidhshmërisë të njëjve organizuese të brendshme dhe institucionet tjera, t'i përcjellë dhe koordinojë punët nga kompetenca e tyre dhe ta avancojë bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë. Lidhur me pajisjet harduerike dhe softuerike në rrjedhë janë aktivitetet për modernizimin e të njëjtës, për shkak të shmangien së rreziqeve të mundshme të ndërprerjes së punës për nënsisteme të caktuara tatimore dhe humbje të të dhënave.

Kanë filluar aktivitetet për zhvillimin, zbatimin dhe përdorimin e sistemit të integruar për evidentimin e pagimeve, për shkak të përmirësimit të sistemit dhe menaxhimit me procesin e punës. Pikërisht, në planin kohor nga Programi i pjesës së „Ndërtimit të sistemit informatikë“, janë planifikuar aktivitete për vendosjen e IT sistemit të ri të integruar, i cili do të sigurojë modernizimin e evidencave tatimore të Drejtorisë për të Hyra Publike, tejkalimin e problemeve me të cilat ballafaqohet sistemi ekzistues, shkëmbim i sigurt i të dhënave me institucionet tjera dhe integrimi i të gjitha të hyrave tatimore në një sistem.

Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë ka kompetencë për zbatimin e mbikëqyrjes doganore, kontrollin doganor të mallrave, hulumtime dhe masave të zbulimit dhe punë të tjera nga sfera e punës doganore.

Gjatë vitit 2016 Drejtoria Doganore ka realizuar të hyra me shumë prej 4.760.740 mijë denarë, që në të hyrat e plotë doganore merr pjesë me 4,89%.

Kemi kryer revizion për mënyrën e lëshimit, evidentimit, pagimit dhe kontrollit në detyrimet e importit dhe akcizave në sistemet e informacionit të Drejtorisë Doganore, dhe kemi konstatuar se proceset e pagimit të detyrimeve doganore të importit janë siguruar me procedurat e përcaktuara dhe udhëzimet shfrytëzuese.

Në rrjedhë është zbatimi i sistemit të ri të integruar, me të cilin pritet të përfshihen të gjitha proceset me të cilat menaxhon Drejtoria Doganore e RM-së. Në pajtim me atë që u cek nevojitet që Drejtoria Doganore e RM-së të vazhdojë me aktivitetet për zbatimin dhe përdorimin e sistemit të integruar për pagesa, për shkak të përmirësimit të sistemit dhe menaxhimit me procedurat e punës.

Të hyrat jo tatimore në vitin 2016 janë realizuar me shumë prej 4.360.579 mijë denarë, derisa janë planifikuar mjete me shumë prej 5.350.000 mijë denarë. Në vitin 2016 janë vlerësuar si më të rëndësishme të hyrat jo tatimore të realizuara nga gjoba, taksa administrative dhe të hyra të tjera jo tatimore nga shërbime të tjera qeveritare. Me analizën e kryer kemi konstatuar se këto të hyra në vitin 2016 janë realizuar në shumë më të vogël 1.133.205 mijë denarë në raport me vitin 2015 përkatësisht 18,49%.

Me Buxhetin e vitit 2016 **të hyrat kapitale** janë planifikuar me shumë prej 2.300.000 denarë, ndërsa janë realizuar me shumë prej 2.456.193 mijë denarë, përkatësisht 6,79% më shumë se planifikimi. Pjesa më e madhe e të hyrave kapitale të cilat janë realizuar në Buxhetin themelor të RM-së janë të hyra, realizimi i të cilave, evidenca dhe kontrolli mbi zbatimin bëhet nga ana e organeve të drejtorisë shtetërore, në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Të hyrat kapitale janë të hyra të Buxhetit themelor të RM-së si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, në raport të përcaktuar me ligj.

Ngarkimi me borxh në vend bëhet përmes lëshimit të letrave me vlerë në afat të shkurtër ose të gjatë, të cilën e lëshon Republika e Maqedonisë me qëllim të grumbullimit të mjeteve në para. Në bazë të ngarkimit me borxh në vend në vitin 2016 është evidentuar grumbullimi i mjeteve në shumë prej 11.115.647 mijë denarë dhe atë në bazë të neto grumbullimeve të letrave me vlerë të lëshuar në afat të shkurtër - bono shtetërore dhe në bazë të letrave me vlerë të lëshuar në afat të gjatë - obligacione shtetërore.

Gjithashtu, në bazë të huamarrjes në vende të huaja, në llogarinë e buxhetit themelor janë realizuar grumbullime të tjera me shumë prej 27.230.077 mijë denarë, nga letrat e lëshuara me vlerë në tregun ndërkombëtar të kapitalit - euroobligacion të Republikës së Maqedonisë. Grumbullimet në bazë të huamarrjes në vende të huaja në vitin 2016 janë rritur në raport me vitin 2016 për 66% për shkak të shumës së lartë të euroobligacionit të ri të lëshuar nga shuma e euroobligacionit të lëshuar në vitin paraprak.

Evidenca për pagimin e të gjitha grumbullimeve dhe harxhimeve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, në buxhetet e komunave dhe institucioneve të tjera në pajtim me ligjin realizohen përmes llogarisë së Thesarit. Menaxhimi me llogarinë e Thesarit dhe llogaritë tjera të shtetit i bën thesari, si njësi organizuese në Ministrinë e Financave.

Me zbatimin e teknikave të revizionit kemi kryer analizë në të dhënat e **sistemit informativ** të vendosur për nevojat e llogarisë së Thesarit, në ç'rast kemi konstatuar se edhe gjatë vitit 2016 llogaria e Thesarit vazhdon të funksionojë përmes dy bazave të të dhënave dhe atë në bazën e të dhënave për transaksionet e grumbullimit për bartjen e mjeteve dhe baza e të dhënave me kërkesa për bartjen e mjeteve në llogaritë e Buxhetit themelor të shfrytëzuesve buxhetor. Gjithashtu kemi bërë krahasimin e të dhënave të evidentuara në dy baza me të cilat menaxhon trezori dhe të dhënat e evidentuara në bazën e kontabilitetit buxhetor, në ç'rast kemi konstatuar se tek shpenzime të caktuara dhe në zërat e të hyrave ka lëshime, lëshime të cilat dalin nga kthimi i mjeteve të paguara gabimisht ose të paguara më shumë në buxhetin themelor si dhe nga dokumentimi i kryer ndërmjet zërave. Për evidencat e përmendura, në bazë të ekzemplarit të përcaktuar, është dorëzuar dokumentacion ndihmës me të cilin konfirmohet autenticiteti i transaksioneve të përmendura. Gjendja e cekur më lartë sugjeron se kontrollet e vendosura i mbulojnë rreziqet në funksionimin dhe avancimin e llogarisë së Thesarit në pjesën e evidentimi të plotë dhe të saktë në hyrjet dhe daljet e mjeteve në Buxhetin themelor të Republikës së Maqedonisë.

Në pjesën e çështjeve tjera e kemi theksuar nevojën e rregullimit plotësues të rregullativës ligjore dhe nënligjore në pjesën e huamarrjes si procedurë me të cilën krijohen obligimet financiare, si dhe marrjen e aktiviteteve për rregullimin e mënyrës së evidentimit të kontabilitetit të pagesave të kryegjësë për bonot shtetërore të maturuara, për shkak të saktësisë së mënyrës së shfaqjes së të dhënave për grumbullimet e realizuara nga huamarrjet dhe për shpenzimet e pagesave të kryegjësë për të njëjtat, në ç'rast duke pasur parasysh parimin e deklarimit të parave për të dhënat në bilancin e raportit financiar për të hyrjet dhe daljet.

Me revizionin e raporteve financiare për vitin 2016 së bashku me revizionin e harmonizimit, e kemi përfshirë punën e rregullt të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe aktivitetet e realizuara për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 11 dhjetor 2016, në ç'rast kemi konstatuar gjendje për të cilat duhet të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e tyre, si vijojnë:

- reregullimin e mënyrës së shfrytëzimit të hapësirave të depove të cilat i shfrytëzon KSHZ-ja dhe evidentimin e tepricave të materialit zgjedhor në librat zyrtar;
- parregullsi gjatë përcaktimit të shumës së kompensimeve të kryetarit dhe anëtarëve të organeve zgjedhore dhe administratës zgjedhore për realizimin e aktiviteteve lidhur me zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare si dhe mungesa e mbulimit të plotë të dokumentacionit për pagimin e të njëjtave;
- regjistrim jo i plotë i mjeteve dhe burimet e mjeteve;
- evidencë jo e plotë e mjeteve ekzistuese dhe obligimet në periudhën për të cilën kanë të bëjnë të njëjtat;
- parregullsi për kompensimet e paguara për shfrytëzimin e automjetit në pronësi personale për shërbime zyrtare të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- parregullsi në mënyrë e zbatimit të procedurave gjatë ndarjes së kontratave për furnizime publike;
- nuk është miratuar udhëzim për organizimin e votimit të anëtarëve të këshillave zgjedhor në përfaqësitë konsullore diplomatike përkatësisht zyrat konsullore të Republikën e Maqedonisë në vende të huaja.

Në pjesën e theksimit të çështjeve për gjendjen alarmante ose vazhdimësinë, revizioni e shfaq mënyrën e sigurimit të mjeteve plotësuese për nevojat e mbajtjes së zgjedhjeve në vitin 2016, si dhe ndikimin e prolongimit të periudhës së konstituimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë pas zgjedhjeve të mbajtura për punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në pjesën e çështjeve të tjera e zbardhëm nevojën e harmonizimit të rregullativës ligjore në pjesën e mënyrës së përcaktimit të kompensimeve për kryetarin, zëvendësin e tij, anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administratën zgjedhore, si dhe harmonizimin e ligjeve të cilat e rregullojnë tatimin e aktiviteteve zgjedhore.

Këshilli i Inspektimit bën koordinimin e punës së nëpunësve të inspektimit, kryen përgatitje dhe përcjellje të zbatimit të metodologjisë dhe procedurave për punën e tyre, i shfrytëzon, jep mendimeve dhe e përcjellë realizimin e programeve vjetore për punën si dhe për punën e inspektorëve, numrin dhe kualitetin e mbikëqyrjeve të kryera nga ana e shërbimeve inspektuese, e përcjellë realizimin e buxheteve, jep pëlqim për aktet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e shërbimeve inspektuese si dhe vepron sipas ligjeve akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare, së bashku me revizionin e harmonizimit, kemi konstatuar disa dobësi sistematike të cilat kanë të bëjnë me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese që kanë të bëjnë në pjesën e:

- rregullimit plotësues dhe mënyrës, afatet dhe dinamika e sigurimit të nevojave të dhëna për regjistrat të cilat i mban këshilli inspektues, në drejtim të sigurimit të evidencës së plotë;
- është i nevojshëm rregullimi plotësues i përcaktimit të vendeve të punës, sipas llojit, kategorisë dhe shumës së shtesave të rrogës në pajtim me nënshkrimin e rreziqeve gjatë punës;
- rregullimi plotësues i procedurës për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të inspektoratit, si dhe hulumtimin e mundësisë për përcaktimin e intervalit kohor të masave disiplinore dhe llojet e përgjegjësisë disiplinore dhe
- ndërmarrja e aktiviteteve nga organet kompetente për harmonizimin e afateve për dorëzimin e propozim programeve vjetore të për shërbimet e inspektimit në Këshillin e Inspektimit, me ligjet të cilat e rregullojnë punën e shërbimeve të caktuara dhe shërbimet e inspektimit.

44 Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë

Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë si organizatë administrative kompetencat e veta i kryen në pajtim me Ligjin për material arkivor që kanë të bëjë me mbrojtjen, ruajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e materialit arkivor, si dhe me kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi materiale e arkivit dhe materialin dokumentar.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare së bashku me revizionin e harmonizimit, kemi konstatuar gjendje për të cilat kemi dhënë rekomandime për marrjen e aktiviteteve për tejkalimin e të njëjtave dhe atë në pjesë e:

- zbatimit të nënshkrimit të mjeteve dhe burimet e mjeteve të kryhet në pajtim me rregullativën ligjore;
- ndërmarrja e aktiviteteve për sigurimin e fletës së pronësisë për objektet në të cilat është vendosur pjesa qendrore e Arkivit Shtetëror;
- vendosja e evidencës së kontabilitetit të objekteve ndërtimore në të cilat janë të vendosur seksionet rajonale;
- përpunimi i llogarisë të detajuar të harxhimeve dhe vlerës së botimeve të cilat i publikon Arkivi Shtetëror;
- gjatë pagesës së kompensimeve për shfrytëzimin e automjeteve personale për qëllime zyrtare të zbatohen zgjidhjet ligjore;
- respektimi i rregullativës ligjore gjatë zbatimit të procedurave për furnizime publike;
- procedura për lidhjen e marrëveshjes për qiramarrje të objekteve ndërtimore që të zbatohet në pajtim me rregullativën ligjore dhe të hyrat e realizuara në bazë zë kësaj të paguhen si të hyra në Buxhetin e RM-së dhe
- dorëzimi i raportit për realizimin e projektit „Maqedonia në shtypin e huaj në shekullin 19 dhe 20“ për Ministrinë e Kulturës.

Gjithashtu e kemi theksuar nevojën në bashkëpunim me organet kompetente që të ndërmerren aktivitete për rregullimin e procedurës së publikimit të materialit arkivor dhe të dokumentuar, llojet e publikimit dhe mënyra e publikimit të tyre, financimit, çmimi i vlerës si dhe shitja e publikimeve.

Partitë politike janë organizata jo fitimprurëse, vullnetare të qytetarëve, të formuara për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave politike, ekonomike, sociale kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera dhe për shkak pjesëmarrjes në procesin e miratimit të vendimeve politike gjatë pjesëmarrjes në pushtet. Partitë politike qëllimet e veta i realizojnë përmes formimit demokratik dhe shprehjes së vullnetit politik me pjesëmarrje të zgjedhjeve, si dhe në mënyrë tjetër demokratike.

Për veprimtarinë e tyre mjetet i sigurojnë nga burimet publike dhe private të financimit. Si burime publike të financimit, mjetet e përgjithshme për financim vjetor të partive politike planifikohen në Buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për çdo vit fiskal, derisa nga burimet e parapara ligjore të financimit privat, partitë politike pjesën më të madhe të mjeteve e sigurojnë nga anëtarësimi dhe donacionet.

Gjithashtu, në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe kryerjes së aktiviteteve të përcaktuar me statutin e partisë dhe me ligj, partitë politike kanë të drejtë në pronësinë e hapësirës afariste, pajisjes, materialit të zyrave, mjeteve të transportit dhe pronës tjetër të luajtshme.

Enti Shtetëror i Revizionit si organ kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën financiare-materiale të partive politike, në vazhdimësi kryen revizion të llogarive për punën e rregullt të partive më të mëdha politike në vend.

Revizioni konstaton parregullsi në veçanti në pjesën e sigurimit të dokumentacionit të kompletuar për vërtetimin e autenticitetit të shpenzime të evidentuara, punës së arkës, zbatimit të regjistrimit të plotë dhe jo të plotë të mjeteve dhe burimet e mjeteve që do të mundësojë vërtetimin e përputhjes së gjendjes së kontabilitetit me gjendjen faktike, pagimin e detyrimeve të llogarisë për punë të rregullt të partisë sipas shpenzimeve të bërë fushatën zgjedhore ose dhënien e borxheve në llogaritë e fushatave zgjedhore.

Revizioni i ka zbardhur edhe gjendjet të cilat rezultojnë me faktorët e jashtëm dhe rrethanat që dalin nga ligjet e caktuar dhe zgjidhjet nënligjore si vijojnë:

- organet kompetente duhet të miratojnë udhëzime më konkrete për veprim lidhur me njohjen e të hyrave dhe shpenzimeve sipas parimit të kontabilitetit të modifikimit, shkaktimit të ndryshimeve afariste përkatësisht transaksioneve dhe evidentimin e tyre, si dhe rregullimi plotësues dhe harmonizimi i akteve nënligjore në të cilat janë përcaktuar pozicionet e kontabilitetit dhe llogaritë për organizatat jo fitimprurëse, të cilat parashohin edhe pozicione të llogarive pranimit të cilave bazohet në parimin e kontabilitetit në „në bazë të llogaritjes“;
- është e nevojshme që organet kompetente të ndërmarrin aktivitete për harmonizimin e akteve nënligjore me burimet e financimit të partive të parapara me rregullativën ligjore në fuqi me formularin e përcaktuar në Raportit vjetor financiar për partitë politike;

- për shkak të veprimit të barabartë tek të gjitha partitë politike, është e nevojshme që organet kompetente të miratojnë drejtime më konkrete për rregullimin e mënyrës së pagimit, pagesat, evidentimi, me qëllim të një trajtimit në mënyrën e evidentimit të tyre të kontabilitetit dhe vërtetimin e limitit të përcaktuar ligjore për çdo anëtar veçmas dhe bartjen e të njëjtave në llogaritë për fushatën zgjedhore dhe
- të bëhet harmonizimi i udhëzimit për shpërndarjen e mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për financimin vjetor të partive politike me Ligjin për financimin e partive politike me qëllim të rregullimit më të saktë për mënyrën e financimit të partive politike nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2016



Me Kodin zgjedhor të Republikës së Maqedonisë është vendosur korniza juridike me të cilën është rregulluar kompetenca e Entit Shtetëror të Revizionit, që t'i rregullojë raportet financiare të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore në Republikën e Maqedonisë. Në raportet financiare janë shprehur të hyrat si rezultat i financimit të fushatës zgjedhore si dhe të hyrat përkatësisht harxhimi i mjeteve për procesin e plotë zgjedhor.

Për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2016, kemi kryer revizion në raportet e plota financiare tek 11 pjesëmarrës në fushatën zgjedhore.


Sipas Kodit zgjedhor, fushata zgjedhore mund të financohet nga anëtarësimi i partive politike, nga persona juridik dhe fizik si dhe nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, derisa mjetet harxhohen për aktivitete të organizatorëve të fushatës zgjedhore.

Sipas të dhënave të paraqitura në raportet e plota financiare, për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2016, nga ana e 11 pjesëmarrësve janë realizuar këto të hyra dhe shpenzime.

Gjithsej të hyra:	228.912 mijë denarë
Gjithsej shpenzime:	235.588 mijë denarë
Shpenzime të pambuluara:	6.676 mijë denarë

Pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë me lëshimin e reklamave dhe propagandave, përkatësisht reklama të paguara politike, si dhe huazimin e hapësirave dhe pajisjeve. Shpenzimet tjera përfshijnë: harxhimet të shërbimeve intelektuale, mëditje për udhëtime zyrtare dhe harxhime të rrugës në vend, shërbime komunale dhe ngrohje, shërbime të komunikacionit, shërbime të PTT dhe harxhimet të tjera.

Llojet e harxhimeve në fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2016



Me revizionin e raporteve financiare të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor i kemi konstatuar këto gjendje:

- donacione të pranuar nga persona fizik sipas shumës së ndarë të cilat e tejkalojnë limitin e përcaktuar në Kodin zgjedhor, si dhe veprim të ndryshëm në raport me shumën e tepërt të pranuar të donacioneve: pagesa në Buxhetin e Republikës, kthimi i mjeteve të donatorëve ose financimi i aktiviteteve zgjedhore;
- shfrytëzimi i huazimeve nga llogaria për punë të rregullt të partive, si dhe mënyra e financimit të fushatës zgjedhore;
- rregullimi jo i plotë i mënyrës së shfrytëzimit të hapësirave, pajisjeve dhe automjeteve, pronësia e partive të ndryshme, anëtarëve të koalicionit;
- një pjesë e kontratave të lidhura dhe faturat e dorëzuara nuk përmbajnë dokumentacion të plotë të mbulimit për vërtetimin e shpenzimeve të shfaqura në fushatën zgjedhore.

Gjithashtu kemi konstatuar gjendje, kompetenca të organeve të tjera në shtet, cilat kanë ndikim mbi konfirmimin dhe verifikimin e shpenzimeve të shfaqura tek pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, mes të cilave më të rëndësishme janë këto:

- një pjesë e radiodifuzerëve, mediet e shtypura dhe elektronike nuk kanë dorëzuar raporte për hapësirën e shfrytëzuar të reklamave dhe listën e çmimeve në organet kompetente;
- lëshimi i faturave të shumave më të mëdha përkatësisht më të vogla për shërbimin e kryer nga ana e radiodifuzerëve lidhur me të dhënat të cilat janë prezantuar në raportet për shërbimet e kryera dhe
- sipas Kodit zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencë për ngritjen e iniciativës për procedurë disiplinore, ngrit kërkesë për vendosjen e procedurës kundërvajtëse, ose ngrit padi penale në organin kompetent për mos respektimin e obligimit;
- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale e Republikës së Maqedonisë në pajtim me Kodin zgjedhor ka për obligim përcjelljen e paraqitjes mediatike të zgjedhjeve dhe servisit programor të radiodifuzerëve dhe medieve elektronike (internet portaleve). Agjencia bën monitorimin e plotë të reklamimit politik vetëm mbi televizionet nacionale, derisa ato rajonale dhe radiodifuzerët lokal janë të përfshirë me ekzemplarin në pajtim me metodologjinë e dhënë. Për shkak të dallimeve të përfshirjes së monitorimit, në pajtim me Kodin zgjedhor dhe metodologjinë e cekur, kemi konstatuar mospërputhje ndërmjet të dhënave të marra nga radiodifuzerët dhe të dhënat e Agjencisë.
Theksojmë se në Kodin zgjedhor kemi konstatuar dobësi të sistemit për të cilat është e nevojshme marrja e aktiviteteve për tejkalimin e tyre:
- saktësimi i financimit të fushatës zgjedhore nga anëtarësimi i partisë politike;
- rregullimi i mënyrës së pagimit të obligimeve të paguara, në rast kur në raportin e plotë financiar shfaqen më shumë të shpenzime se të hyra si dhe mënyra e veprimit me mjetet e pashfrytëzuara në llogarinë e fushatës zgjedhore;
- harmonizimi i dispozitave në Kodin zgjedhor lidhur me afatet për mbylljen e llogarisë së transaksionit, përgatitja dhe dorëzimi i raporteve të plota financiare, afati i pagimit të donacioneve dhe afati i pagimit të kompensimit për pjesëmarrje në fushatën zgjedhore nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- përcaktimi i obligimeve për personat juridik të ekonomizojnë me panoa reklamuese dhe bilborde, komunat në Republikën e Maqedonisë dhe Qytetit i Shkupit të përgatisin dhe dorëzojnë raport për reklamat, panoat dhe bilbordet e shfrytëzuar dhe mjetet të cilat janë paguar ose kërkohen në këtë bazë dhe
- vendosja e monitorimit për reklamat e paguara politike përmes medieve elektronike (internet portaleve) si dhe zgjerimi i obligimit që të njëjtët të përgatisin dhe dorëzojnë raport për hapësirën e shfrytëzuar të reklamave dhe mjeteve të cilat janë paguar ose kërkohen në bazë të kësaj.

Komisioni i Letrave me Vlerë është trup rregullator i pavarur me autorizime publike të përcaktuara në rregullativën ligjore dhe aktet nënligjore. Komisioni e rregullon kontrollon punën e letrave me vlerë nga vlera e territorit të Republikës së Maqedonisë, në korniza të kompetencave të veta ligjore dhe autorizimeve, kujdeset për funksionimin ligjore dhe efikas të tregut të letrave me vlerë dhe për mbrojtjen e të drejtave të investitorëve, me qëllim të përforcimit të besimit të opinionit në institucionet e tregut të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë.

Kemi kryer revizion të raporteve financiare për vitin 2016 së bashku me revizionin e harmonizimit dhe kemi konstatuar gjendje për të cilat nevojitet marrjen e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e tyre, mes të cilave më të rëndësishme janë:

- harmonizim i pakryer i akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Komisionit në pajtim me rregullativën ligjore;
- Me Kontratën kolektive të lidhur me Organizatën Sindikale pranë komisionit, të punësuarve u jepen më shumë të drejta nga të drejtat e përcaktuar me ligjet të cilat i rregullojnë të njëjtat;
- janë konstatuar parregullsi në mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve;
- ekziston mungesa e prezantimit të rregullt, kronologjik, në kohë dhe saktë të librave afaristë në bazë të dokumentacionit të rregulluar, të plotë dhe ndihmës, dhe
- ekzistojnë parregullsi në mënyrën e zbatimit të procedurave gjatë ndarjes së kontratave për furnizime publike.

Në pjesën e çështjeve tjera e theksuam nevojën që organet kompetente të dorëzojnë drejtime më konkrete për veprim lidhur me njohjen e të hyrave dhe shpenzimeve të Komisionit, sipas parimit të kontabilitetit të shkaktimit të modifikuar të ndryshimeve afariste përkatësisht transaksionit.

Gjithashtu Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, si organ i cili i ndryshon anëtarët e Komisionit, nevojitet miratimi i aktit të ri me të cilin do të rregullohet mënyra dhe shuma e përcaktimit të drejtës së rrogës, kompensimeve të rrogës, si dhe kompensimeve për harxhime materiale dhe të ardhurave tjera.

Institucionet shëndetësore publike, harmonizimi i punës e vërteta dhe objektiviteti i raporteve financiare



Mbrojtja shëndetësore, përfshinë një sistem të masave shoqërore dhe individuale, aktivitete dhe procedura për: ruajtjen dhe avancimin e shëndetit, pengimin, zbulimin e hershëm dhe çrënjosjen e sëmundjes, plagë dhe çrregullime të tjera të shëndetit të shkaktuara nga ndikimi i mjedisit të punës dhe mjedisit jetësor, kurim efikas dhe në kohë si dhe përkujdesje shëndetësore dhe rehabilitim të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Mbrojtja shëndetësore bazohet në unitet të masave preventive, të diagnozës, të rehabilitimit dhe në parimin e dinjitetit, efikasitetit, vazhdimësisë, drejtësisë, gjithë përfshirjes dhe sigurimi i trajtimit kualitativ dhe të sigurt shëndetësor.

Veprimtaria shëndetësore është veprimtari me interes publike dhe e njëjta zhvillohet në nivel primar, sekondar dhe terciar të mbrojtjes shëndetësore nga ana e institucione shëndetësore publike dhe private.

Me programin vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2017 u përfshinë më shumë institucione publike shëndetësore në nivele të ndryshme, ndërsa me revizionin e kryer në raportet e tyre financiare dhe revizionin e harmonizimit për vitin 2016 megjithatë kemi konstatuar gjendje të cilat kanë të bëjnë me:

- parregullsi të konstatuara në sistemin e kontrolleve interne të cilat duhet të sigurojnë besim të matur për arritjen e qëllimeve në institucionet shëndetësore publike lidhur me autenticitetin e informimit financiar, çështjen efektive dhe efikasitetin në punën e harmonizimit me ligjet dhe dispozitat e zbatueshme;
- nuk janë marrë aktivitete nga ana e ministrisë kompetente për dhënien e instruksioneve në kohë dhe pëlqime për Statutet e institucionet shëndetësore publike si bazë e miratimit të akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- emërimin e kryerësve të detyrës drejtor të ISHP për periudhë më të gjatë se ajo e caktuar ligjërisht;

- mungesa e kontratës së lidhur nga menaxheri për rregullimin e të drejtave të ndërsjella dhe obligimeve mes ministrit të Shëndetësisë dhe kryerësit të detyrës drejtor i ISHP-së;
- veprim jo përkatës i mjeteve në para të paguara në dorë për shërbimet e kryera shëndetësore;
- pamundësi e konstatimit të mjeteve të plota të paguara dhe shfaqja e tyre si të hyra në raportet financiare;
- parregullsi në mënyrën e zbatimit të hulumtimeve klinike dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve;
- mungesa e vendosjes së evidencës së pajisjeve mjekësore dhe vendosja e sistemit efikas për përcjelljen dhe mirëmbajtjen e të njëjtës;
- harmonizim i plotë dhe i rregullt i vlerës dhe sasisë së mjeteve;
- prezantimi i gjendjeve reale të tepricave si dhe harxhimi i tyre gjatë vitit;
- nuk merr aktivitete për pagimin në kohë të kërkesave për shërbimet e kryera shëndetësore dhe
- zbatimi jo konsekuent i dispozitave ligjore për furnizime publike në procedurat për ndarjen e kontratave për furnizime publike, prolongime të dokumentacionit dhe përcjellje e realizimit të kontratave të lidhura.

Për gjendjet e konstatuara nga ana e revizionit janë dhënë rekomandime për veprim, ndërsa zbatimi i tyre nga ana e organeve kompetente dhe personat përgjegjës në shërbimet shëndetësore publike do të kenë për efekt përmirësimin e kualitetit të shërbimeve të dhëna ndaj qytetarëve.

Operatori i sistemit elektro-përçues i Republikës së Maqedonisë SH.A. „MEPSO“



Shoqëria Aksionare „MEPSO“, si operator i sistemit elektro-përçues në Republikën e Maqedonisë, bën përçimin e energjisë elektrike dhe menaxhon me sistemin elektro energjetik në Republikën e Maqedonisë, dhe është përgjegjëse për punën e sistemit, mirëmbajtjen e tij, zhvillimin dhe lidhshmërinë e sistemeve elektro përçuese në vendet fqinje dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate në sistemin për përmbushjen e nevojave të arsyeshme për përçimin e energjisë elektrike. SH.A. „MEPSO“ është në pronësi shtetërore dhe kryen veprimtari të

interesit publik që janë lëndë e rregullimit nga ana e Komisionit Rregullator të Energjetikës, e cila jep licenca si kusht që të fillohet me kryerjen e veprimtarisë.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2016 dhe revizionin e harmonizimit tek SH.A. MEPSO për vitin 2016, janë konstatuar disa gjendje të cilat kanë ndikimin në punën e shoqërisë dhe atë në pjesën e:

- zhvillimit dhe sigurisë së IT sistemit, organizimin, qasje në resurse, menaxhimin dhe evidentimin e aplikacioneve softuerike dhe licencat me të cilat disponon shoqëria, shfrytëzimi i aplikacioneve për punë arkivore dhe menaxhimet me regjistrat tregtarë janë në rrethim kontrollues që kërkojnë marrjen e aktiviteteve plotësuese për funksionimin pa pengesë të IT sistemeve dhe mbrojtjes së të dhënave të cilat i gjenerojnë të njëjtat;
- është e regjistruar e drejta e hipotekës „hipotekë“ e pronës e cila është në pronësi të përbashkët me një subjekt tjetër juridik pa njoftimin e shoqërisë;
- për 95 sende të paluhatshme me vlerë të plotë të furnizimit prej 3.624.967 mijë denarë nuk janë siguruar fletët e pronësisë nga agjencia kompetente;
- delegimi i kompetencave të personit për lidhjen e kontratës për shitblerje të pronës së patundshme me shumë prej 4.812.500 euro që në pajtim me aktet interne nuk iu kanë besuar punë juridike që paraqet kusht për veprim në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare;
- është furnizuar sistem i kompjuterizuar afarist i informatikës (BIS) me vlerë prej 37.813 denarë dhe për të njëjtin nuk janë krijuar kushte për shfrytëzimin e tij të plotë;
- jo çdo herë në procedurat për ndarjen e kontratave për furnizime publike;
- në kohë është siguruar publikimi i konkurseve në shtypet zyrtare të BE-së;
- janë përmendur kriteret për dëshminë e gjendjeve ekonomike dhe financiare, si dhe aftësinë teknike dhe profesionale të cilat nuk janë paraparë me dispozitat e Ligjit për furnizime publike;

- janë kryer furnizime të cilat nuk janë të përmbajtur specifkimet teknike;
- është lidhur kontratë për furnizime publike me shumën 102.088 mijë denarë edhe krahas asaj që për të njëjtën është arritur çmimi më i ulët i ankandit elektronik me shumë prej 31.657 mijë denarë;
- është lidhur kontratë për realizimin, rekonstruktimin dhe adaptimin e fasadave për realizimin e të cilave janë konstatuar më shumë mangësi dhe lëshime përmes të cilave edhe kryerja e punëve të rregullta dhe tepricave me shumë prej 87.879 mijë denarë të cilat paraqesin lëndë në procedurën gjyqësore, punët plotësuese me shumë prej 1.200 denarë të cilat nuk janë të rregulluara me aneks kontratën, punë të paparashikuara me shumë prej 13.111 mijë denarë të cilat nuk janë të rregulluara me kontratë, sipas informatave të mbikëqyrjes për përfundimin e punëve të cekura nevojiten edhe 27.558 mijë denarë dhe nuk është kryer sigurimi i objektit;
- realizimi i kontratës së lidhur për hua nga kreditorë ndërkombëtar nuk kryhet në pajtim me afatet e përcaktuara në ç’rast për tërheqjen jo në kohë të mjeteve në emër të provizionit janë paguar mjete në shumë prej 693.993 eurosh;
- mjetet e paguara në emër të regresit për pushim vjetor mbi të drejtën ligjore të përcaktuar me shumë prej 5.143 mijë denarë.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni ka dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe aktiviteve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara dhe sigurimin e veprimit përkatës në punën e SH.A. MEPSO.

Njëkohësisht theksojmë se është kryer zbardhje e gjendjeve të caktuara të cilat mund të ndikojnë në punën e subjekteve në të ardhmen, dhe nuk kanë të bëjnë me:

- mënyrën e rregullimit të drejtave të ndërsjella dhe obligimeve ndërmjet Shoqërisë dhe organizatave sindikale dhe financimin e aktiviteve të sindikatës;
- të drejtat e përcaktuara të punësuarve në marrëveshjet kolektive në nivelin e punëdhënësit;
- ndërtimi i objekteve të cilat nuk janë në veprimtarinë e shoqërisë dhe dhënia e tyre personave të tjerë juridikë si donacion;
- procedura gjyqësore me shumë prej 743.548 mijë denarë në të cilat shoqëria është paditës dhe procedura me shumë prej 2.303.535 mijë denarë në të cilën shoqëria është palë e paditur;
- procedurat e marra gjyqësore nga ana e shoqërisë dhe shoqërive tjera të cilat janë në pronësi shtetërore në të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë i kryen të drejtat dhe obligimet në Kuvendin e shoqërisë, pa u kërkuar në këtë rast veprim përkatës nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në drejtim të shmangies së harxhimeve në emër të kompensimit të shërbimit të avokatit, taksave gjyqësore, ekspertizave etj.

Rekomandimet e dhëna nga ana e revizionit, konkluzionet e miratuara nga organet kompetente për mënyrën e veprimit të SH.A. „MEPSO“ dhe subjekte të tjera të involvuar, si dhe masat dhe aktivitet të cilat i marrin këshilli drejtues dhe mbikëqyrës i shoqërisë, janë në drejtim që të sigurojnë gjendjet e konstatuara dhe sigurimin e harmonizimit të punës, në pajtim me aktet ligjore, nënligjore dhe të brendshme.

Gjatë vitit 2017, Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizion të rregullsisë për vitin 2016 në pjesë njësi të vetëqeverisjes lokale, komuna, Qendër, Karposh, Kavadar, Saraj dhe Studeniçan. Komunitet të cilat ishin lëndë e revizionit, karakteristike ishte ajo që krahas rebalancit të miratuar të Buxhetit ka lëshime të dukshme mes të hyrave të realizuara dhe atyre të planifikuara. Pikërisht, gjatë konstatimit të të hyrave administrata komunale nuk ka kryer vlerësim real të resurseve të veta financiare në pajtim me rregullativën ligjore e cila bazohet në të hyrat e realizuara gjatë vitit 2016, si dhe në të dhënat historike, ndërsa me këtë jo realisht është përcaktuar shuma maksimale e shpenzimeve komunale në vitin fiskal. Kjo tregon se rebalanci i Buxhetit, me të cilën rritet projeksioni i të hyrave të planifikuara në nivel vjetor, nuk mbështetet në të dhënat relative për rritjen e të hyrave, me këtë edhe nuk respektohen drejtimit e dhëna në cirkularin buxhetor nga Ministria e Financave.

Me përjashtim të Komunës Qendër tek komunat tjera nuk është plotësuar obligimi ligjor lidhur me dorëzimin e raportit vjetor për shfrytëzimin e mjeteve nga kompensimet për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtruara pa leje, në organin e drejtorisë shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës (Ministria e Transportit dhe Lidhjeve).

Tek katër nga komunat e reviduara nuk është vendosur sistemi dhe procedura për revizion të brendshëm, që nuk është në pajtim me nenin 23 të Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik dhe neni 37-a paragrafi 2 i Ligji për buxhete, për shkak të cilës ekziston rreziku që të mos kryhet menaxhim efikas i mjeteve publike.

Shpesh janë konstatimet të cilat kanë të bëjnë me ligjet dhe aktet e brendshme që flasin për mos harmonizimin e punës me rregullativën ekzistuese ligjore. Të pranishme janë dobësitë e transfereve të mjeteve në para për shoqëri dhe fondacione, si dhe pagimi i kompensimeve sociale.

Tek një pjesë e njësive të reviduara të vetëqeverisjes lokale është karakteristike dukuria e pagimit për të cilat nuk ekziston dokumentacion i kompletuar mbështetës, si dhe prova se shërbimi i kryer përkatësisht malli është furnizuar.

Tek një pjesë e komunave të reviduara ende nuk është kryer procedura për vlerësimin dhe evidentimin e pronës së ndarë me vendim të vitit 2000 nga Qeveria e RM-së.

Tek komunat e reviduara është e pranishme dukuria e regjistrimit të mjeteve dhe burimet e tyre në fund të vitit të përgatitet jo e kompletuar dhe jo e plotë.

Në këtë raport vjetor do t'i theksojmë dobësitë e sistemit të cilat janë aktuale tek njësitë e vetëqeverisjes lokale, dhe kanë të bëjnë me Ligjin për tatimet e pronës, Ligjin për taksa komunale, Ligjin për zjarrfikës, Ligjin për ndërtim, Ligjin për përmbarim dhe Ligjin për sport. Këto dobësi të sistemit kanë implikime financiare në punën e njërive të vetëqeverisjes lokale dhe konsiderojmë se organet kompetente duhet të marrin masa për tejkalimin e tyre.

Ligji për tatimin e pronës

Në pajtim me nenin 39 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për tatimin e pronës, komuna, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit rregullisht duhet ta harmonizojnë gjendjen e regjistrin të patundshmërive me regjistrin të cilin e mban Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive e Republikës së Maqedonisë, ndërsa më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzohet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe deri në Drejtorinë e të Hyrave Publike - drejtorinë qendrore.

Nuk bëhet harmonizimi i të dhënave në regjistrat e pronës së patundshme të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Republikën e Maqedonisë me të dhënat e Sistemit të informacionit gjeodezik - të kadastrës (SIGJK) të Agjencisë së Kadastrës së Patundshmërive, për shkak të bazave jo të harmonizuara për evidentimin e të dhënave (regjistrave) përkatësisht në qytetin dhe komunat në Republikën e Maqedonisë, obliguesit tatimor janë të evidentuar sipas numrit amë dhe të dhënave të tjera personale, ndërsa në Sistemin e informacionit gjeodezik të kadastrës në Agjencisë së Kadastrës janë të regjistruar sipas komunës së kadastrës dhe parcelës së kadastrës. Harmonizimi paraqet obligim ligjor i njërive të vetëqeverisjes lokale, ndërsa harmonizimi i tyre reflektohet në kompletimin e të dhënave tek njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe ka implikime fiskale të kompletimin e të hyrave në bazë të kësaj.

Për të pasur mundësi njësitë e vetëqeverisjes lokale, shpejt dhe në mënyrë kualitative ta azhurnojnë bazën e të dhënave për tatimin e pronës, nevojiten regjistra kompatibilë dhe lidhshmëri softuerike me organet shtetërore dhe institucionet (Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, Regjistri Qendror, DHP dhe institucione të tjera).

Ligji për taksa komunale

Pagesa e **taksave komunale për shfrytëzimin e rrugëve me automjete për udhëtarë, automjete ngarkuese, motorike, automjete speciale dhe motoçikleta - numri tarifar 9** në pajtim me Ligjin për taksa komunale, është e përcaktuar që ta kryejë organi kompetent për regjistrimin e automjeteve dhe ta paguajë në llogarinë përkatëse në kuadër të llogarisë së thesarit për komunën, për komnatat e Qytetit të Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit në rajonin e të cilit është kryer pagesa. Në zgjidhjet ekzistuese ligjore nuk është përcaktuar në cilat afate duhet të bëhet pagesa e taksave në llogari të komunës, obligimi për informimin e komunës për numrin e automjeteve të regjistruara varësisht sa kubikë janë, shuma e taksës komunale, për shumën mujore të mjeteve të grumbulluara veçmas dhe komulative. Me dispozitat ekzistuese ligjore nuk është vendosur sistemi i cili do të siguronte të dhëna të sakta për automjetet e regjistruara sipas vëllimit të punës dhe dedikimit, ndërsa nga ana tjetër komnatat nuk kanë obligim ligjor që të mund të konstatojnë saktësinë dhe të vërtetën e mjeteve të paguara dhe shumën e plotë të të hyrave në bazë të kësaj.

Në bazë të taksës komunale për ndriçim rrugor, komnatat në Republikën e Maqedonisë nga ana e EVN-së Maqedonisë SH.A Shkup nuk marrin të dhëna për:

- numrin e obliguesve sipas kategorisë (numrin e matësve) në pajtim me tarifën numër 10 të Ligjit për taksa komunale;
- raport për shumën mujore të mjeteve të grumbulluara veçmas dhe në mënyrë komulative;
- raport gjashtëmujor për gjendjet reale me numrin e matësve dhe
- informim për kërkesa e papaguara në bazë të kësaj takse komunale.

Pikërisht në Ligjin ekzistues për taksa komunale nuk është përcaktuar obligimi i dorëzimit të të dhënave të cekura, ndërsa për tejkalimin e kësaj gjendje nga ana e EVN-së Maqedoni dhe BNJVL-së është lidhur Memorandum për bashkëpunim.

Edhe krahas Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet BNJVL-së dhe EVN-së Maqedonisë SH.A. Shkup, nga ana e EVN-së nuk respektohen obligimet kontraktuese të nenit 6 të Memorandumit për dorëzimin e të dhënave dhe raporteve të lartpërmendur. Efektet nga kjo praktikë e vendosur reflektohen në çështjen e kompletuar dhe saktësinë e të hyrave të realizuara në bazë të kësaj, të cilat komnatat i evidentojë në kontabilitet vetëm si të derdhje pa të dhëna konkrete për të njëjtat. Me qëllim të sigurimit të tërësishëm dhe transparencës së pagimeve për të hyrat personale të komunave, revizioni llogaritet se është i nevojshëm ligjvënësi të kryejë plotësim të zgjidhjes ligjore në funksion të tejkalimit të dobësive të theksuara.

Ligji për zjarrfikës

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit për zjarrfikës, për financimin e aktiviteteve të njësive territoriale të zjarrfikësve (NJTZ), Qyteti i Shkupit dhe komunat në Republikën e Maqedonisë kanë mundësi për sigurimin e të hyrave plotësuese nga pagimi i gjobave në para për kundërvajtje të kryera nga sfera e mbrojtjes nga zjarri dhe eksplodimet, punë vullnetare dhe mjete të tjera nga shoqëri të sigurimit, fonacione, persona fizik dhe juridik për avancimin e mbrojtjes nga zjarri dhe të hyra nga burime personale për shërbimet e realizuara.

Qyteti i Shkupit dhe komunat në Republikën e Maqedonisë nuk realizojnë të hyra në bazë të kësaj, përpos të hyra nga shoqëritë e sigurimit me shumë prej 2% nga premitë e paguara për sigurimin e automjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i automjeteve motorike, për të cilat nuk kanë njohuri për shumën e mjeteve që duhet të paguhet në bazë të kësaj, as që kanë obligim ligjor që të konfirmojnë saktësinë e autenticitetit për mjetet e paguara. Saktësia jo e volitshme në definimit e zgjidhjeve ligjore për llojet e tjera të të hyrave për financimin e NJTZ kontribuon për mos realizimin e të hyrave në bazë të kësaj.

Organet kompetente duhet të ndërmarrin masa dhe aktivitete në drejtim të saktësimin të zgjidhjeve ekzistuese ligjore dhe definimi i llojeve të tjera të të hyrave për financimin e NJTZ.

Ligji për përmbarrim

Në pajtim me nenin 218 të Ligjit për përmbarrim¹ zbatimi i të cilit është në fuqi nga 01.01.2017 përkatësisht neni 211 i Ligjit për përmbarrim „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. (35/2005,50/2006, 129/2006, 8/2008, 83/2009, 50/10, 83/10, 88/10, 171/10, 148/11 и 187/13), i vijon:

„Mbi lëndët dhe të drejtat e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk mund të zbatohet përmbarrimi për pagimin e kërkesave në para, nëse ato janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre, përkatësisht detyrave.

Cilat lëndë dhe të drejta janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë dhe detyrave të debitorit do të vendos kryetari i gjykatës në rajonin ku zbatohet veprimtaria e kryer, nëse gjatë zbatimit të përmbarrimit, palët për këtë çështje nuk pajtohen ose ndryshe sugjerohet ajo si nevojë. “

Duke i shfrytëzuar dispozitat e anëtarëve të lartpërmendur kryetarët kompetent të gjykatave themelore vendase sjellin vendime për shumën e mjeteve në para të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarive të cilat përjashtohen nga përmbarrimi, ndërsa bazohen në ekspertizën e bërë nga persona ekspertë. Gjatë veprimit në këto raste nuk merren parasysh dispozitat e Udhëzimit për mënyrën e realizimit të urdhërësive për përmbarrim të cilat e obligojnë llogarinë e thesarit ose llogarinë e thesarit shëndetësor, përkatësisht debitorit

¹ Gazeta Zyrtare e RM-së nr.72/16 и 142/16

i cili gjendet në kuadër të llogarisë së thesarit ose llogarisë të thesarit shëndetësor, të miratuar nga Ministria e Financave si dhe dispozitat e nenit 210 të Ligjit për përmbarim.

Revizioni konsideron se gjatë veprimit në këto raste edhe krahas dispozitave të Ligjit për përmbarim duhet të kihet parasysh edhe dispozitat e akteve nënligjore të cilat dalin nga Ligji për qarkullim pagesor.

Ligji për sport

Financimi i aktiviteteve nga sfera e sportit dhe rekreacionit, janë paraparë në listën e kompetencave të komunave, në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 pika 6 e LVL, megjithatë nuk është në kompetencë të komunave të Qytetit të Shkupit, në të cilat bie edhe Komuna e Karposhit, të definuar në nenin 15 të Ligjit për Qytetin e Shkupit, sipas të cilit në punët me interes publik nuk është i përfshirë sporti, si kompetencë e komunave në Qytetin e Shkupit, përkatësisht në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 i ligjit të njëjtë, kjo kompetencë iu është dhënë Qytetit të Shkupit.

Nga ana tjetër, në nenin 22-a të Ligjit për sport, janë përcaktuar kompetencat e komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, në sferën e sportit, mes të cilave janë edhe zhvillimi i sportit masiv dhe aktivitetet rekreative të qytetarëve, organizimi i ngjarjeve sportive dhe manifestimeve, mirëmbajta dhe ndërtimi i objekteve sportive, përkrahja dhe avancimi i sportit, klubet sportive, klubet profesionale sportive dhe përkrahja e lidhjeve komunale dhe Lidhjes së Sportit në Qytetin e Shkupit, ndërsa për zbatimin e tyre, këshillat e komunave dhe Qyteti i Shkupit ose komisioni i komunës, komunës së Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit kompetent për sportin miratojnë program me propozim të lidhjeve komunale të sportit dhe Lidhjes së Sportit të Qytetit të Shkupit. Gjithashtu, sipas këtij neni, programet janë definuar nga buxheti i komunave dhe buxheti i Qytetit të Shkupit, donacione dhe sponsorime, ndërsa për plotësimin e programeve dhe afateve të përcaktuara në tek ato, nga komunat e këshillave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, lidhjet e sporteve të komunave dhe Lidhjet e sporteve të qytetit të Shkupit, dorëzojnë raport.

Në pajtim me atë që u përmend, revizioni është i mendimit se nevojitet harmonizim i dispozitave ligjore nga aspekti i definimit më të saktë dhe më të qartë dhe përkufizimi i kompetencave në sferën sportit, për komunat e Qytetit të Shkupit, mënyra dhe kushtet e miratimit të programit të veçantë në kuadër të komunave, të miratuar nga Këshilli dhe financimi i aktiviteteve të tilla me mjete të miratuara në buxhetin e komunës.

Ligji për ndërtim

Me ndryshimet e Ligjit për ndërtim në muajin shkurt dhe shtator të vitit 2014 me nenin 67-a zgjerohen kompetencat e këshillave komunal, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit në pjesën e miratimit të vendimeve për përcaktimin e dukjes së fasadave të një ose më shumë objekteve dhe rekonstruktimi i fasadave të ndërtesave kolektive banesore, nëse komunat përcaktojnë se është e rëndësishme për komunës. Në këto raste investitor është komuna, pa u definuar se në cilat raste përcaktimi i dukjes së fasadës të njërit ose më shumë objekteve është me domethënie për komunën. Me takimet e nenit 67-a të Ligjit për ndërtim, komunave iu është dhënë kompetencë të cilat janë në pajtim me kompetencat e komunave të përcaktuara në dispozitat e nenit 22 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, që është ligj sistematik, pa e saktësuar dhe përcaktuar se cili objekt është me domethënie për komunën dhe si e njëjta dëshmohet. Këto kompetenca krahas Ligjit për vetëqeverisje lokale nuk përcaktohen dhe nuk janë në pëlqim me kompetencat e komunave të Qytetit të Shkupit të përcaktuar në nenin 15 të Ligjit për Qytetin e Shkupit dhe nenet prej 101 deri 104 të Ligjit për banim. Revizioni është i mendimit se me zgjidhjen e tillë ligjore ekziston kolizion tek rregullativa ligjore e cila i rregullon kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Ndërmarrjet publike në nivel lokal

Në vitin 2017, në pajtim me programin vjetor të punës kemi kryer revizion të mbarëvajtjes në tre ndërmarrje të nivelit lokal NP „Parqe dhe Gjelbërime“ në Qytetin e Shkupit, NKP „Komunalec“ Kërçovë dhe në Ndërmarrjen Publike për Veprimtari Komunale „Komunalec“ Gjevgjeli.

Me revizionimin e **NP „Parqe dhe Gjelbërime“** i konstatuam këto gjendje:

- nuk janë vendosur procedura dhe mekanizma kontrollues për llogaritjen e pagimit të rrogave për të punësuarit dhe nuk është përcaktuar procedura;
- llogaritja dhe pagesa e rrogave për të punësuarit bëhet në bazë të rregulloreve të miratuara për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe rregullores për rroga nga viti 2008, të cilat janë të harmonizuara në mënyrë të ndërsjellë dhe nuk janë të harmonizuara me Statutin dhe Ligjin për marrëdhënie pune, si dhe zbatimi i vlerës së pikave për të cilën nuk është miratuar akti nga ana e Këshillit drejtues;

- regjistrimi i kredive afat shkurte dhe kreditë nga shoqëritë e lidhura në vend dhe në investimet në filiale nuk janë kryer në mënyrë të përcaktuar në pajtim me dispozitat ligjore;
- tek objektet ndërtimore, nuk është kryer regjistrim i plotë në pajtim me dispozitat ligjore, në ç'rast për një pjesë të objekteve të cilat kanë status juridik të objekteve të ndërtuara pa leje nuk është ngritur procedurë për legalizim e cila është në rrjedhë, ndërsa pjesa më e madhe e objekteve nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për kategorizimin e tyre në objekte;
- mënyra e financimit të aktiviteteve për mirëmbajtje të rregullt të gjelbërimeve publike të qytetit, bëhet në bazë të vendimit të miratuar në nëntor 2012, pas vlerësimit të përcaktuar nga Këshilli i Qytetit të Shkupit, me shumë prej 19,5% nga çmimi i paguar i shërbimeve për furnizim me ujë të pijshëm dhe derdhjen e ujërave të zeza urbane vendim i cili duhet të jetë me karakter kohor, ndërsa ende zbatohet;
- në evidencën e kontabilitetit janë evidentuar kërkesa dhe janë realizuar të hyra nga shoqëritë e lidhura (NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi), harmonizimi i vlerave të këtyre kërkesave, si dhe shpenzime dhe të hyra në bazë të vlerës së tyre të harmonizuar dhe pagimi i kërkesave të shlyera, për të cilat nuk ekziston akt i shkruar i përcaktuar nga të dy subjekte;
- kryegjëja bazë e shprehur dhe e evidentuar në regjistrat tregtar dhe në raportet financiare, nuk është e shënuar në Regjistrin Qendror të RM-së, si dhe investimi në para dhe jo në para i ndërmarrjes publike, përkatësisht nuk ka kapital të regjistruar dhe të paguar në pronësi të shtetit në emër të themeluesit - Qyteti i Shkupit;
- në periudhë prej 2001 deri 2016, janë paguar mjete në llojin e ndihmës financiare në Florakom dhe Luna, SHPKPV, të themeluar nga NP Parqe dhe Gjelbërim, për të cilat nuk ekziston dokument i shkruar, përpos marrëveshje të lidhura për huazime në vitin 2015 dhe 2016, me afat të kthimit prej një viti. Mjetet e paguara nga dita e revizionit nuk janë kthyer në llogari të ndërmarrjes publike;
- NP „Parqe dhe Gjelbërim“, si themelues/pronar dhe partner, në periudhën e kaluar nuk kanë sjellë vendim për mbulimin e humbjeve të shfaqur në llogaritë vjetore dhe raportet e vjetore financiare të shoqërive Florakom dhe Luna, me të cilat nuk është vepruar në pajtim me aktet për themelimin e dispozitave ligjore dhe
- mënyra e sigurimit të mjeteve për financimin e veprimtarisë komunale - ngritjen (ndërtimin) dhe rrethimin e gjelbërimit për përdorim publik dhe rregullimin me dispozita të Ligjit për veprimtari komunale dhe Ligjin për gjelbërim, megjithatë i njëjti në periudhën e tanishme nuk zbatohet në mënyrën e përcaktuar me dispozitat ligjore.

Tek **NPK Komunalec Kërçovë**, ndërmarrje publike e cila i mbulon veprimtaritë komunale me karakter publik i konstatuam këto gjendje:

- nuk është lidhur kontratë ndërmjet kryetarit të Komunës së Kërçovës dhe drejtorit të N.P. në të cilën janë përcaktuar rregullat, obligimet dhe përgjegjësitë;

- nuk përpilohet raport për punën e NP e cila duhet të përmbajë të dhëna për llojin dhe vëllimin e punëve të kryera dhe të dorëzohet te kryetari i komunës;
- kryerja e shërbimeve komunale, pastrimi publik bëhet pa evidencë përkatëse prej të cilës mund të konstatohet se çka është kryer me çfarë vëllimi dhe nuk përgatiten dhe dorëzohen fatura në komuna për vlerën e punëve të kryera;
- kompensimi për shfrytëzimin e ujit të pijshëm dhe derdhjen e ujërave të zeza nuk paguhet në Buxhetin e RM-së;
- është evidentuar një përqindje e madhe e humbjeve teknike dhe komerciale e ujit, si dhe është karakteristike faturimi i harxhimit të ujit për çdo anëtar në ekonomi familjare (paushall);
- nuk ka evidencë të plotë për shfrytëzimin e tregjeve të qytetit;
- kryerja e punëve me ndihmën e automjeteve ngarkuese motorike zhvillohet pa pasur evidencë të plotë dhe të plotësuar se kush e ka dhënë fleturdhëresën e punës, ku dhe për çfarë qëllimi do të përdoret automjeti;
- kërkesat e shprehura nga blerësit nuk japin pasqyrim real për numrin dhe vlerën e kërkesave të paditura, mundësia për pagimin dhe kërkesat, si dhe kërkesat e blerësve për të cilat merren aktivitete për likuidim ose falimentim dhe
- vazhdim i afatit të ofertave gjatë zbatimit të procedurave për furnizime publike pa u ndryshuar ose plotësuar dokumentacioni i tenderit.

Ndërmarrja Publike për Veprimtari Komunale „Komunalec“ Gjevgjeli është e themeluar për kryerjen e veprimtarisë komunale me interes publik në Komunën e Gjevgjelisë. Grumbullimin, përpunimin dhe furnizimin me ujë, derdhjen e ujërave të zeza, grumbullimin, përpunimi dhe largimin e hedhurinave, sanimin e shërbimeve të tjera në menaxhimin e hedhurinave, ndërtime të ulëta, depozitimin e veprimtaritë ndihmëse në transport, shërbime me mirëmbajtjen e ndërtesave.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve të konstatuara me revizionin e kryer, kemi dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me:

- harmonizimin e dispozitave të statutit me rregullativën ligjore;
- sistematizimin e nëpunësve publikë në pajtim me pikat e parapara për çdo vend pune dhe përcaktimin e shumës së vlerës së pikave për llogaritjen e pagave të nëpunësve publik;
- miratimi i politikave të kontabilitetit, me të cilat rregullohen specifikat, parimet, bazat, rregullat dhe praktikat, të cilat i zbatojnë ndërmarrjet publike gjatë përgatitjes dhe prezantimit të raporteve financiare;
- përcaktimin e investimit bazë dhe regjistrimin e tij në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, si kapital në pronësi shtetërore në emër të themeluesit;

- vazhdimi me aktivitetet e filluara për përcaktimin e statusit të objektit të cilin e shfrytëzon për kryerjen e veprimtarisë së vet;
- vlerësimi i pagimit të kërkesave në fund të çdo periudhe për informim dhe shfaqjen e tyre reale në regjistrat tregtar dhe në raportet financiare;
- mënjanimin e faktorëve të cilët kontribuojnë për humbjen e ujit në sistemin e furnizimit me ujë, për shkak të faturimit objektiv real dhe pagimin e harxhimeve të sasive të harxhuara të ujit.

Në pjesën e çështjeve tjera e potencojmë nevojën e hulumtimit të gjendjeve të caktuara të cilat janë me domethënie për punën e ndërmarrjes publike, ndërsa kanë të bëjnë me organet kompetente:

- miratimi i akteve nënligjore të parapara në Ligjin për përcaktimin e çmimit të shërbimeve të ujit, në funksion të vendosjes së sistemit efikas të përcaktimit të çmimit të shërbimeve të ujit dhe
- rishikimin e dispozitave të Ligjit për përmbarrim dhe Ligjit për noteri, në pjesët të cilat e rregullojnë procedurën e pagimit të borxhit për shërbime komunale.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve revizioni ka dhënë rekomandime për marrjen e aktiviteteve nga ana e personave përgjegjës dhe organeve kompetente.

Ministria e Kulturës

Ministria e Kulturës si organ i administratës shtetërore, në pajtim me Ligjin për organizimin e punës të administratës shtetërore i kryen punët që kanë të bëjnë me: përcjelljen, analizimin dhe propozimin e akteve dhe masave për zhvillimin dhe avancimin e kulturës; organizimin, financimin dhe zhvillimin e rrjetit të institucioneve nacionale dhe financimin e programeve dhe projekteve me interes nacional në këtë sferë, mbrojtje të pasurisë kulturore, veprimtarisë botuese, muzikore, skenike-artistike, të filmit, galerisë, bibliotekës, arkivit, muzeut dhe kinotekës, veprimtarisë në shtëpitë e kulturës dhe veprimtaritë për ndërmjetësim në kulturë, mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat e ngjashme, shënimin e ngjarjeve përkujtimore dhe persona të shquar me interes nacional dhe mbikëqyrje në kompetencë të saj.

Me revizionin e kryer të rregullsisë për vitin 2016 i kemi konstatuar këto gjendje:

- objektet „Teatri i Vjetër“ në Shkup, „Muzeu i Luftës Maqedonase për Shtetësi dhe pavarësi“, „Muzeu i VMRO-së“ dhe „Muzeu i viktimave të regjimit komunist“ - Shkup janë vendosur në përdorim para se të kryhet pranimi teknik dhe përgatitet raporti për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës;

- është pranuar përpilimi i projektit për ndërtimin e Sallës universale, pa e pasur parasysh se e njëjta për shkak të llojit të objektit, formës së saj dhe madhësisë, fasadës specifike, si dhe vëllimin dhe llojin e përmbajtjeve të paraparë në programin e projektit dhe në zgjidhjen ideore është disa herë më i shtrenjtë se vlera e përcaktuar fillestare, për këtë shkak e njëjta nuk është realizuar;
- sipas certifikatës së planit detal urbanistik për rajonin qendror të qytetit për Qytetin e Shkupit, Ringun e vogël, ndërtimi i objektit me kompozim skulptural është me dedikim kulturor dhe i përfshinë të gjitha llojet e veprimtarive të cilat zhvillohen në ndërtime specifike siç janë teatri, kinematë, sallat, muzetë, galeritë, kinotekat, shtëpitë e kulturës, filarmonitë, opera etj, ndërsa objekti nuk i takon asnjë ndërtimi specifik të vërtetuar në shifrën e dedikimit;
- pagesat e situatave kohore për ndërtimin e kompozimeve skulpturore parashihen nga programi 50 - Mbrojtje të trashëgimisë kulturore zëri 482 - Objekte të tjera ndërtimore prej ku janë paguar, që nuk përputhet me dedikimin e përcaktuar me këtë program. Me këtë bëhet pagim joligjor, për shkak se paratë nuk janë të dedikuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por për ndërtimin e objekteve përmes të cilave do të prezantohet jeta dhe vepra e Nënë Terezës;
- sipas marrëveshjeve të lidhura me furnizues të huaj është furnizuar pajisje e skenës, dritës dhe zërit për nevojat e teatrove në RM dhe janë kryer punë ndërtimore për përpunimin, dërgimin, instalimin, montimin, hulumtimin dhe lëshimin në përdorim të pajisjeve dhe instalimeve për sistemet teknologjike të skenës. Obligimet ndaj furnizuesve të huaj janë paguar me hapjen e akreditivit në Bankën Popullore të RM-së, në të cilën është e përfshirë e TVSH-ja;
- ndërtimi i Teatrit në Veles“ në Veles ka filluar që në vitin 2008, ndërsa në vitin 2016 ende janë duke u zhvilluar aktivitete dhe janë lidhur kontrata për punët e paparapara, afatet e parapara në kontratat bazë kanë tejkaluar dhe ka një numër të madh të procedurave për negociata për punët e paparapara në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- nga ana e bartësit të furnizimeve janë kryer punë ndërtimore para se të jepet oferta dhe të lidhen marrëveshjet për të njëjtat për objektin Teatri i Velesit në Veles;
- për objektin „Teatri i Velesit“ në Veles nuk është kryer kontroll teknik, është kryer vetëm kontroll i brendshëm teknik në faza më 02.06.2015, me të cilin janë konstatuar më shumë vërejtje dhe pozicione të jashtme. Edhe krahas asaj që teatri është lëshuar në përdorim në qershor 2014, në të njëjtin ende janë duke u kryer punë ndërtimore;
- në Ministrinë e Kulturës në rrjedhë është realizimi i 11 projekteve kapitale për botimin e librave, me vlerë të plotë prej 557.822 mijë denarë, që kanë filluar prej vitit 2009 ende janë në vazhdim. Revizioni nuk u bind për nevojën e interesit nacional për shtypjen e këtyre librave nga shkak që më 31.12.2017 në tepricë ruhen 514.494 libra me vlerë prej 301.273 mijë denarë;

- për konkursin e shpallur për ndarjen e mjeteve financiare për projekte të interesit nacional nga sfera e kulturës nuk vendos kriter për ndarjen e shumës së mjeteve të cilat do të ndahen për bartësit e projekteve. përcaktimi i shumës së mjeteve me të cilat do të përkrahen projektet e pranuar nga ana e ministrisë bëhet në bazë të vlerësimit të anëtarëve të komisionit;
 - për konkursin vjetor për ndarjen e mjeteve financiare për projekte të interesit nacional nga sfera e kulturës, ndaras sipas veprimtarive janë konstatuar dobësi të caktuara në mënyrën e punës së komisioneve në të gjitha veprimtaritë nga sfera e kulturës;
 - regjistrimi i mjeteve dhe burimeve të mjeteve nuk është realizuar në pajtim me aktet e përcaktuara ligjore dhe nënligjore, është kryer pas realizimit të afatit të paraparë dhe nuk është e harmonizuar gjendja e kontabilitetit me atë faktike;
 - obligimet në evidencën e kontabilitetit nuk evidentohen në kohë në momentin e realizimit të shërbimit, por në momentin e pagimit të njëjtës, që ka për efekt shfaqjen jo reale të obligimeve ndaj furnizuesve;
 - Ministria e Kulturës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e zgjidhjes ideore për përpunimin e kompozimit të skulpturës me ndarjen e çmimeve dhe si pjesë e procedurës për ndarjen e kontratës për furnizime publike për përpunimin e zgjidhjes ideore që paraqet kombinim të dy procedurave;
 - për ndërtimin e objektit salla e madhe e koncerteve në Filarmoninë e Maqedonisë, në planet vjetore për furnizime publike nuk janë paraparë si shumë vjeçare, ndërsa në vendimet për zbatimin tyre si dhe në mendimin e Ministrisë së Financave është paraparë dinamikë shumëvjeçare për realizimin e tyre;
 - Bartësit e furnizimit për tepricat e përcaktuara dhe shkurtimet e punëve, për objektin Filarmonia e Maqedonisë, nuk e kanë informuar organin kontraktues për nevojën e mjeteve dhe kohën për realizimin e tyre siç parashihej në kontratën dhe në pajtim me dispozitat ligjore.
- Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni ka dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe aktivitetëve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.
- Në pjesën e theksimit të çështjeve alarmante dhe si vazhdimësi, revizioni e ka theksuar gjendjen e cila ka të bëjë me:
- Ndërtimi i objekteve kapitale zgjatë më gjatë dhe për të njëjtat janë përfshirë më shumë kontrata, planifikohen në nivel vjetor dhe nuk janë paraparë si pjesë e ndarë e Buxhetit të RM-së;
 - Nga Buxheti i RM-së në llogarinë MK - financimi i veprimtarisë nga sfera e kulturës janë paguar mjete në para me shumë prej 300.000 mijë denarë. Pagimi i mjeteve në para është në bazë të Vendimit të Qeverisë për llogarinë e Qytetit të Shkupit në emër të rikonstruktimit të fasadave të objekteve në qendër të qytetit, ndërsa të njëjtat janë në zërin mbrojtje të trashëgimisë kulturore që paraqet mjete të harxhuara në mënyrë joligjore;

- Procedura e plotë lidhur me ndërtimin e kompozicionit të skulpturës nuk jep pasqyrim të qartë të karakterit të objektit, me atë edhe respektimi i rregullativës përkatëse ligjore. Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni ka dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara. Në pjesën e theksimit të çështjeve alarmante dhe vazhdimësi, revizioni e ka theksuar gjendjen e cila ka te beje me:
- Ndërtimi i objekteve kapitale zgjatë me gjatë dhe për të njëjtat janë lidhur kontrata shumëvjeçare, planifikohen në nivel vjetor dhe nuk janë paraparë si pjesë e ndarë e Buxhetit të RM-së;
- Nga Buxheti i RM-së në llogarinë MK - financimin e veprimtarisë nga sfera e kulturës janë paguar mjete në para me shumë prej 300.000 denarë. Pagimi i mjeteve në para është në bazë të Vendimit të Qeverisë për llogarinë e dedikuar të Qytetit të Shkupit në emër të rikonstruktimit të fasadave të objekteve në qendër të qytetit, ndërsa të njëjtat janë nga zëri i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore që paraqet mjete të harxhuara në mënyrë joligjore;
- Procedura e plotë lidhur me ndërtimin e kompozicionit të skulpturës nuk jep pasqyrim të qartë të karakterit të objektit, me atë edhe respektimin e rregullativës përkatëse ligjore.

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale është organ shtetëror, kompetencat ligjore i ka në sferën e funksionalitetit të sistemit të vetëqeverisjes lokale për shkak të sigurimit të shërbimeve publike kualitative dhe të barabarta për qytetarët, si për zhvillim të barabartë të shtetit, përmes nxitjes së vetëqeverisjes lokale të zhvillimit rajonal dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Me revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e harmonizimit tek Ministria e Vetëqeverisjes Lokale për vitin 2016, janë konstatimet si vijojnë:

- sistemi i kontrollit të brendshëm nuk funksionon në tërësi dhe krijon rrezik të ndryshimit dhe humbjes së të dhënave të kontabilitetit;
- janë kryer pagesa në bazë të ndryshme me dokumentacion të pakompletuar;
- gjatë vitit 2016 nuk është miratuar Plani strategjik vjetor për revizionin e brendshëm dhe nuk kryhet revizion i brendshëm në ministri;
- obligimet në evidencën e kontabilitetit nuk evidentohen në kohë në momentin e realizimit të shërbimit, por në momentin e pagimit të së njëjtës, që ka për efekt shfaqjen jo reale të obligimeve ndaj furnizuesve;
- për zhvillim të barabartë rajonal janë ndarë 227 milionë denarë për vitin 2016, që është nën limitin e paraparë ligjor dhe arrin 0,04% nga BPV. Ndarja e më pak mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për këtë qëllim nuk kontribuon për zvogëlimin e pabarazisë rajonale dhe realizimin e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm rajonal;

- regjistrimi për vitin 2016 nuk është i realizuar në tërësi dhe nuk respektohen dispozitat e Rregullores së kontabilitetit të buxheteve dhe shfrytëzuesve buxhetor;
- Ministria, në emër të Qeverisë së RM-së, më 27.12.2016 ka lidh Marrëveshje për ndarjen e harxhimeve mes Qeverisë dhe Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), për projektin „Zgjidhje inovative për qasje më të mirë në shërbimet e nivelit lokal“. Kontrata është lidhur në periudhën e miratimit të Vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Me mjetet financiare menaxhon UNDP në pajtim me dispozitat, rregullat, politikat, procedurat e brendshme dhe të jashtme të revizioneve të UNDP-së. Me qëllim të përmirësimit të gjendjeve, revizioni ka dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

Revizion i përputhshmërisë

1. Marrja e obligimeve financiare dhe jo stabiliteti financiar tek njësitë e Vetëqeverisjes Lokale

Në pajtim me programin vjetor për vitin 2017 kemi bërë revizionin e përputhshmërisë me temë marrja e obligimeve financiare dhe jo stabiliteti financiar tek njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Me këtë revizion kemi përfshirë të gjitha komunat përmes pyetësorit, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministrinë e Financave - Sektorin e Buxhetit dhe Sektorin e Thesarit në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me rregullativën ligjore. Në pyetësorët kemi marrë përgjigje prej 95% nga komunat në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht prej 77 komunave. Në ç’rast kemi zgjedhur 12 komuna në të cilën revizionin e kemi zbatuar me teknika të kontrollit të dokumentacionit dhe grumbullimin e provave si vijojnë: Kumanovë, Zelenikovë, Gradsko, Negotinë, Berovë, Pehçevë, Zhelinë, Bogovinë, Tetovë, Delçevë, Zërnovci dhe Karabinci. Me revizionin e kemi përfshirë periudhën prej 2012 deri 2016, ndërsa për çështje të caktuara periudha përfundimisht me muajin maj 2017.

Me revizionin e kryer i kemi përcaktuar këto gjendje:

- karakteristike është gjendja e planifikimit jo real të buxheteve, me lëshimet e dukshme në të hyrat e planifikuara në raport me ato të realizuara si vijojnë: për vitin 2012 të hyrat e buxhetit janë realizuar me 64%, për vitin 2013 me 61%, për 2014 me 63%, për 2015 me 65% dhe për vitin 2016 60%;

- Edhe pas rebalancit të kryer në buxhete nuk tejkalohen gjendjet e mos harmonizimit të të hyrave të planifikuara dhe të realizuara. Ka komuna tek të cilat edhe krahas realizimit minimal të buxhetit nuk përpilohet dhe nuk miratohet rebalanci i Buxhetit. Planifikimi jo real i buxheteve është karakteristikë dhe në miratimin e Programit për veprimtari të caktuara të cilat janë në kompetencë të komunave, të cilat edhe krahas mos realizimit të buxheteve nuk ndryshohen dhe nuk zvogëlohet vëllimi i punëve të përcaktuara sipas planit dhe aktiviteteve, ndërsa nga ana tjetër u mundëson kryetarëve të komunave të zbatojnë procedura për furnizime publike dhe të marrin obligime edhe pse nuk ka mundësi reale nga sigurimi i mjeteve;
- pjesëmarrje e obligimeve të pa maturuara ndaj furnizuesve më 31 dhjetor prej vitit 2012 deri 2016, lidhur me të hyrat e realizuara sipas viteve në nivel të komunave, lëvizë prej 25% deri 44%, ndërsa pjesëmarrja e obligimeve të pa maturuara sipas huazimeve afatgjate dhe kredive më 31 dhjetor prej 2012 deri 2016 në raport me të hyrat e realizuara në nivel të komunave lëvizë prej 11% deri 18%;
- ka dallim mes të dhënave për obligimet afat shkurta ndaj furnizuesve dhe obligimeve afate gjata në baza të ndryshme, të prezantuara në pyetësorët të cilët ishin dorëzuar në komuna nga ana e Entit Shtetëror të Revizionit, me të dhënat e shprehura në Bilancin e gjendjeve dhe në të dhënat e dorëzuara në komuna në raportet tremujore për Ministrinë e Financave dhe evidencën e komunave;
- nënshkrimi i obligimeve ndaj furnizuesve shpesh paraqet specifikë të saldoshme me gjendjet më 31 dhjetor të vitit për të cilin bëhet regjistrimi, pa u konstatuar baza juridike, përkatësisht dokumentacioni prej të cilave të njëjtat dalin, data/viti prej kur rrjedhin.
- lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për disiplinë financiare lidhur me afatet për pagimin e obligimeve ndaj furnizuesve, kemi konstatuar se tek një pjesë e komunave nuk zbatohen dispozitat e Ligjit, ndërsa tek komunat me llogari të bllokuara nuk ekzistojnë mundësi reale për zbatim;
- asnjëra nga komunat në të cilat i plotësojnë kushtet për jo stabilitet financiar nuk ka vepruar në pajtim me Ligjin për financimin e njësisive të vetëqeverisjes lokale, për shkak se nuk kanë shpallur jo stabilitet financiar dhe nuk kanë i kanë marrë aktivitetet e nevojshme.
- mjetet e përcaktuara me Vendim për shumën e mjeteve në para të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së komunave, të cilat përjashtohen nga realizimi, të miratuara nga kryetaret e gjykatave themelor kompetente vendase, që janë me shumë të cilat mundësojnë pagimin e shumës sipas urdhërësave të realizuara sipas të cilave janë bllokuar llogaritë e komunave;
- prej 14 komunave të bllokuara, 11 komuna janë me status bllokim dhe limit të përcaktuar me vendim gjyqësor;

- tek 3 komuna kemi konstatuar se përqindja e pjesëmarrjes së limitit në të hyrat e plota të realizuara të komunave është më i madh, përkatësisht tek njëra komunë kemi përcaktuar që limiti i nivelit vjetor është për 34% më i madh nga të hyrat e plota në nivel vjetor, tek tjerat për 28% dhe tek komuna e tretë për 4%;
 - komunat të cilat i plotësojnë kushtet për jo stabilitetin financiar edhe krahas gjendjes së tillë, kanë filluar projekte të reja kapitale, kanë punësime të reja dhe avancime për të punësuarit e tyre, ndërsa është e pranishme edhe dukuria që të kryejnë pagimin e obligimeve ndaj furnizuesve me llogaritje (faktorizimi, kompensimi etj), me të cilën puna e tyre është në kundërshtim me rregullativën ligjore;
 - borxhi i plotë i komunave me llogari të bllokuara në maj 2017 arrin 2.035.715 mijë denarë të konstatuara sipas shumës së plotë të urdhëresave për realizim, ndërsa kamata është llogaritur në shumë prej 410.078 mijë denarë. Kamata është llogaritur nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në ditën e përpilimit të specifikimit. Shuma përfundimtare e të njëjtës do të përcaktohet me realizimin e plotë të urdhëresave për përmbarim;
 - në nivel komunal huazimi i plotë sipas urdhëresave për përmbarim për periudhën 2012-2016 arrin 1.253.723 mijë denarë në vitin 2012, ndërsa në vitin 2016 1.900.685 mijë denarë, përkatësisht kemi konstatuar rritje më të madhe të borxhit të komunave në RM në vitin 2016 në raport me vitin 2012 për 51,6%;
 - ka komuna të cilat janë me llogari të bllokuara prej vitit 2005 përkatësisht 2008, të cilat kanë hyrë në fazën e dytë të decentralizimit edhe pse nuk i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj dhe
 - një pjesë e komunave të cilat kanë përdorë hua nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë i kanë kthyer mjetet e huazuara, por pjesa më e madhe e komunave nuk i kanë kthyer mjetet e huazuara, edhe pse afati për atë ka kaluar.
- Për tejkalimin e gjendjeve të përcaktuara revizioni ka dhënë rekomandime për organet kompetente në nivel lokal dhe ministrinë kompetente për shkak se gjendja është alarmante, ndërsa nuk janë marrë masa për tejkalimin e së njëjtës.

2. Përcaktimi i pagesës dhe shfrytëzimi i kompensimeve të cilat janë të obligueshme t'i maturojnë operatorët e instalimeve, puna e së cilës ndikon në mjedisin jetësor

Mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor është sistem i masave dhe aktiviteteve (shoqërore, politike, sociale, ekonomike, teknike, arsimore dhe të tjera) me të cilat sigurohet përkrahje dhe krijohen kushte për mbrojtje nga ndotja, degradimi dhe ndikimi mbi mediet dhe sferat e ndara të mjedisit jetësor (mbrojtje nga sosja e mbështjellësit të ozonit, pengimi i zhurmës së dëmshme dhe vibracioneve, mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues, mbrojtje nga era pakëndshme dhe depozitimi i hedhurinave dhe llojeve të tjera të mbrojtjes së mjedisit jetësor).

Punët nga sfera e mjedisit jetësor i kryer Ministria e Mjedisit Jetësor përkatësisht Drejtoria e Mjedisit Jetësor, e cila është kompetente për dhënien e lejeve ekologjike, përcaktimin e kompensimeve të cilat janë të obliguar t'i paguajnë operatorët e instalimeve të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe menaxhimin me regjistrin e lejeve të lëshuara. Menaxhimi i Kadastrës së mjedisit jetësor, regjistri i ndotësve dhe monitorimi i mjedisit jetësor janë në kompetencë të Qendrës Informative të Maqedonisë - sektori në Ministri.

Në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor operatorët me instalime aktivitetet e të cilës kanë ndikim në mjedisin jetësor, janë të obliguar të sigurojnë leje të integruar ekologjike (LIE)



ose leje për harmonizimin me planin operativ (LHPO) si kusht për vazhdimin, përkatësisht fillimin e punës së instalimeve, deri në plotësimin e kushteve për marrjen e LIE-së.

Leja lëshohet si A-LIE nga ana e Ministrisë ose B-LIE nga ana e komunave ose Qytetit të Shkupit. Kur bëhet fjalë për instalim i cili gjendet në rajonin e mbrojtur, e lëshon Ministria.

Me revizionin e kryer të konstatimit, pagimi dhe shfrytëzimi i kompensimeve të cilat janë të

obliguar t'i maturojnë operatorët e instalimeve të cilat kanë ndikim në mjedisin jetësor, kemi konstatuar se:

- kompensimi vjetor për posedimin e lejes dhe mbikëqyrjen e rregullt në pjesën e llogarive nuk është e saktë dhe plotësisht e përcaktuar për shkak të sistemit jo efikas të kontrollit të brendshëm, saktësi jo të volitshme të dispozitave ligjore dhe nënligjore si dhe për shkak të zbatimit jo përkatës i të njëjtave;

- lejet, ndryshime dhe bartjet e të njëjtave, si dhe aktvendimet për kompensim jo çdo herë jepen dhe evidentohen në mënyrë përkatëse dhe në kohë për shkak të cilës mungojnë informata të plota dhe nuk kryhet llogaritje e rregullt, përcjellje dhe pagim i kompensimit përkatës;
- një numër i madh i operatorëve nuk e kanë ruajtur afatin ligjor për realizimin e planeve operative dhe zbatimin e LHPO dhe LIE-s, që ndikojnë në kualitetin e mjedisit jetësor dhe të hyrave në Ministri;
- nuk është i vendosur Sistemi Nacional Informativ i cili do t'i përfshinte të gjitha të dhënat dhe nuk është e përcaktuar forma për mënyrën e udhëheqjes dhe grumbullimit të shpërblimeve për të njëjtat, as që ka të dhëna të plota në Kadastrën e mjedisit jetësor dhe Regjistrin e ndotësve;
- nuk janë siguruar mjetet e nevojshme dhe kuadrot profesionale për akreditimin e Laboratorit qendror dhe të kalibracionit pranë ministrisë;
- evidenca e vendosur e kërkesave në bazë të kompensimeve të përcaktuara nuk është e kompletuar, e saktë dhe e azhurnuar, nuk përpilohet raport për strukturën e kërkesave dhe nuk ndërmerren aktivitete për pagimin në kohë për të njëjtat;
- pjesa më e madhe e kërkesave të shprehura në librat afarist kanë të bëjnë me kërkesat e tre operatorëve të instalimit dhe të njëjtat nuk e reflektojnë gjendjen reale të kërkesave të pakompletuara për shkak të pamundësisë së pagimit të kërkesave nga masa falimentuese dhe deklaratat e paevidentuara për kompensim me operatorët e instalimeve;
- mjetet nga kompensimi i paguar vjetor për posedimin e lejeve dhe për mbikëqyrjen e rregullt të instalimeve nuk shfrytëzohen për dedikimet e parapara me ligjin por për financimin e projekteve dhe aktiviteteve të tjera të parapara me Programet vjetore për investim në mjedisin jetësor;
- pjesa më e madhe e mjeteve të parapara me Programet vjetore për investime në mjedisin jetësor janë të dedikuara për mbrojtjen ruajtjen dhe përmirësimin e kualitetit të ujërave, pjesa më e vogël e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike, edukimin, trajnimin dhe nxitjen e studimeve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore, programe dhe projekte, dhe as që parashihen mjete për mbrojtjen avancimin dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit, sanimin dhe ndërtimin e depove për hedhurina, përpunimin dhe seleksionimin e hedhurinave as për sfera të tjera të mjedisit jetësor;
- kriteret e publikuara në konkurse publike nuk sigurojnë konkurrencë dhe objektivitet të mjaftueshëm gjatë evoluimit dhe zgjedhjes së aplikuesëve dhe projekteve/programeve për të cilat shfrytëzohen mjetet;
- mungon monitorimi i plotë dhe kontrolli nëse mjetet e ndara për projektet shfrytëzohen në pajtim me marrëveshjet e lidhura dhe ekziston rreziku që mjetet jo çdo herë të shfrytëzohen për nxitjen, ruajtjen, mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor.

Për tejkalimin e gjendjeve të përcaktuara janë dhënë rekomandimet për marrjen e masave dhe aktiviteteve përkatëse të cilat janë në drejtim të sigurimit të mjeteve përkatëse të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm - përmbushjen e nevojave për mjedisin e shëndosh jetësor të gjeneratave të tanishme, pa u rrezikuar të drejtat e gjeneratave të ardhshme që t'i përmbushin nevojat personale.

3. Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë



АГЕНЦИЈА ЗА ВРАБОТУВАЊЕ НА
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në drejtim të lehtësimit të proceseve të punësimit për personat invalidë, Republika e Maqedonisë në kuadër të Agjencisë ka formuar fond të veçantë përmes të cilit bëhet ndarja e mjeteve për financimin dhe punën e përmirësimit të kushteve për punësim dhe punë të personave invalidë, adaptimi i vendit të punës, kontributi për sigurim pensional dhe invalidor, kontributi për sigurim shëndetësor dhe kontributi për punësimin e personin invalid të punësuar, kontributi për sigurim pensional dhe invalidor për të gjithë të punësuarit në shoqërinë mbrojtëse dhe furnizimi i pajisjeve.

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizion të harmonizimit të aktiviteteve dhe masave të marra për shfrytëzimin e mjeteve të fondit të veçantë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 dhe me revizionin e kryer tek Agjencia janë konstatuar këto gjendje:

- Ekziston nevoja e tejkalimit të dobësive të caktuara dhe të pathënave tek aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat e rregullojnë ndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve të llogarisë në fondin e veçantë, me çka do të mundësohej qasje e barabartë në mënyrën e ndarjes së mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre me dedikim;
- Nuk sigurohen mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në bazë të TVSH-së së paguar dhe doganave nga ana e shoqërive mbrojtëse, si njëri nga burimet e financimit të fondit të veçantë;
- Këshilli drejtues i Agjencisë nuk ka vendosur në kohë për një pjesë të kërkesave për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme nga fondi i veçantë, të dorëzuara vitin e kaluar, në ç'rast në disa raste vonesa ke qenë prej një deri në tre vjet;

- Edhe pse në vitin 2011 ka skaduar mandati i Komisionit për dorëzimin e Konstatimit dhe mendimit për përcaktimin e vendeve të punës të cilat mund t'i kryejë personi invalid të vendin e punës përkatës, ai filloi ta kryejë funksionin e vet, që ndikon në vlefshmërinë e konstatimeve dhe mendimeve të përfunduara. Në pjesën më të madhe të konstatimeve dhe mendimeve të lëshuara është përcaktuar se nuk realizohet takim drejtpërdrejtë me personin invalid siç është paraparë me dispozitat e akteve nënligjore që e rregullon mënyrën e miratimit të tyre, me të cilën zvogëlohet objektiviteti në vlerësimin e gjendjeve dhe konstatimit të përgatitur nga komisioni dhe
- Mungojnë aktivitete mbikëqyrëse mbi zbatimin e përcaktimeve të Ligjit për punësimin e personave invalidë dhe mbikëqyrje inspektuese e cila ka të bëjë me kushtet e veçanta për punësimin dhe punën e personave invalidë në shoqatat mbrojtëse dhe shoqëritë tregtare të cilat punësojnë persona invalidë.
Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime në raport, sipas të cilave presim që organet kompetente dhe personi përgjegjës i Agjencisë të ndërmerr masa dhe aktivitete për tejkalimin e tyre.

4. Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë



**ФОНД НА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО
ОСИГУРУВАЊЕ НА МАКЕДОНИЈА**

Enti Shtetëror i Revizionit ka bërë revizionin e harmonizimit të furnizimeve publike në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë për vitin 2016.

Me revizionin e kryer kemi konstatuar gjendje të caktuara si vijojnë:

- Sistemi i kontrollit të brendshëm në procesin e planifikimit të furnizimeve publike zbatohet pa procedurë për përcaktimin e nevojave vjetore të mbuluara me analiza të përgatitura, të plota dhe drejtime të harmonizuara për veprim në pjesën e prioriteteve në furnizimin dhe iniciimin nga palët e njësive organizuese. Aktivitetet e zvogëluara të Sektorit për Furnizime Publike krijojnë rrezik nga shkaktimi i lëshimeve të caktuara gjatë zbatimit të procedurave për furnizime publike prej të cilave në një pjesë prej të njëjtave gjatë revizionit janë tejkaluar;

- Janë planifikuar dhe zbatuar procedura për furnizime publike për të cilat revizioni nuk siguron prova të mjaftueshme për përcaktimin e prioriteteve dhe nevojat për furnizimin e tyre;
- Janë bërë furnizime të shërbimeve hoteliere pa u zbatuar procedura përkatëse të furnizimeve publike;
- Për furnizime të caktuara publike gjatë definimit të kriterëve nga specifikacioni i teknikës dhe dëshmia e aftësisë teknike dhe profesionale nuk është vendosur kriter minimal i përcaktuar me aktin nënligjor nga sfera e dhe nuk ka përputhje me kriteret e cekura me analizën e tregut në tërësi;
- Gjatë zbatimit të procedurave të veçanta për furnizimin e shërbimeve komisioni për furnizime publike (KFP) në fazën e evolucionit të ofertave gjatë kontrollit të vlefshmërisë dhe dokumentacionit të plotë për përcaktimin e aftësive të ofertuesve nuk ka kërkuar nga ofertuesit të sqarohen ose plotësohen dokumentet;
- Te procedura për furnizime publike tek të cilat është realizuar ulja e çmimeve sipas ankandit të realizuar elektronik është vendosur praktikë, që marrëveshja për furnizime publike të lidhet me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur pa u dorëzuar ofertë me çmimin e plotë të zvogëluar/ çmime sipas zërit në raport me çmimin fillimisht të ofruar. Me zbatimin e procedurave për vitin 2017 janë ndërmarrë aktivitete për tejkalimin e dobësive të konstatuara;
- Është lidhur marrëveshje për furnizim të energjisë elektrike (EE) me shumë më të madhe se çmimi i ofruar në e-ankand, përkatësisht vlera e kontratës është me shumë të vlerës së vlerësuar të përcaktuar me Vendimin për furnizime publike. Gjatë kryerjes së revizionit është lidhur aneks marrëveshje në pajtim me çmimin e arritur në e-ankand.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhëne rekomandime në raport, sipas të cilave presim që organet kompetente dhe personi përgjegjës i Fondit të ndërmerr masa dhe aktivitete për tejkalimin e tyre.

Në pjesën e theksimit të çështjeve të dyshimta dhe vazhdimësisë, revizioni ka kryer zbardhjen e disa gjendjeve të cilat kanë të bëjnë me digjitalizimin e lentave të mikrofilmave që është kryer nga ana e operatorëve ekonomik (OE) në bazë të kontratave të lidhura për furnizime publike të shërbimeve dhe nevojës për hulumtimin e mënyrës që duhen të digjitalizohen lentat tjera të mikrofilmave në periudhën e ardhshme.

5. Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë



Enti Shtetëror i Revizion ka kryer **revizion të përputhshmërisë për ndjekjen e shlyerjes së detyrimeve për pagimin e kontributeve të arritura, e të papaguara për sigurim të detyrueshëm shëndetësor në Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2016.**

Me revizionin e kryer në Fond është konstatuar se:

- shuma e përcaktuar e kontributit të përgjithshëm të papaguar për sigurim të detyrueshëm shëndetësor që ka ndodhur përfundimisht me 31.12.2008 nuk është përcaktuar saktë, për shkak të evidencës së paplotë dhe të pasaktë të numrave tatimore dhe emërtimeve të subjekteve si dhe shumave dhe periudhës së ngarkimit me borxh të subjekteve;
- të dhënat e marrë nga shërbimet rajonale dhe Sektori për punë juridike lidhur me procesin e ndjekjes së pagesës së kërkesave në bazë të kontributit të papaguar nuk përputhen për shkak të mos koordinimit në veprimin dhe mungesës së aktiviteteve koordinuese për sigurim të mënyrës së unifikuar të ndjekjes së kërkesave në bazë të kontributit të papaguar nga ana e Qendrës së Fondit;
- edhe krahas pritjeve të Fondit se numër i madh i detyrësve do t'i shfrytëzojnë volitshmëritë nga Ligjet për pezullim dhe Ligji për falje të kamatave, jehona e detyrësve ka qenë e pamjaftueshme;
- Marrëveshja e lidhur për evidentim dhe ndjekje të kërkesave, ndërmjet Drejtorisë së të Hyrave Publike (DHP) dhe Fondit nuk është në pajtim me Ligjin për kontribute për sigurim të detyrueshëm social, përkatësisht me të njëjtën nuk është përcaktuar obligim që DHP-i t'ua dorëzojë informatat e përcaktuara ligjore institucioneve, gjë që ka ndikim mbi plotësinë e kërkesave të paraqitura në bazë të kontributit të papaguar në raportet financiare të Fondit. Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara Fondi për revizion për personat përgjegjës të Fondit revizioni dha rekomandime për ndërmarrje të masave dhe aktiviteteve adekuate.

Revizioni i performancave

Në vitin 2017 bëmë 4 revizione të suksesit në pajtim me Programin vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2017, me të cilat përfshimë 113 subjekte.

Të gjitha revizionet e bëra të performancave kanë të bëjnë me vlerësimet, të fokusuara në cilësinë dhe sasinë e mjeteve publike dhe shërbimeve në sferat të cilat janë konstatuar rreziqe të konsiderueshme financiare dhe mundësi për përmirësime sociale dhe sistemore dhe janë krijuar indikatorë me të cilat revizioni e plotësoi vlerën e tij të shtuar në lidhje me aktivitetet e zgjedhura.

1. Efikasiteti i masave, politikave dhe projekteve për mbrojtjen e pyjeve në Republikën e Maqedonisë

Pyjet paraqesin një pjesë të pasurisë nacionale, përkatësisht trashëgimi të Republikës së Maqedonisë dhe si të mira me interes të përgjithshëm për Republikën gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës i RM-së sipërfaqja e përgjithshme nën pyjet është 983 388 hektarë, prej të cilave 90% janë në pronësi shtetërore, ndërsa 10% në pronësi private.

Revizionin e performancave e realizuam me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes „Vallë institucionet kompetente ndërmarrin masa, aktivitete dhe projekte për mbrojtje efikase të pyjeve në Republikën e Maqedonisë“, dhe si të japim vlerësim për kornizën strategjike dhe juridike për mbrojtje të pyjeve në RM, financimin e mbrojtjes si dhe masave të ndërmarra për mbrojtje efikase.

Në pjesën e miratimit dhe implementimit të akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me mbrojtjen e pyjeve në RM, konstatoam se nuk janë ndërmarrë aktivitete për përpunim të një pjese të zgjidhjeve të parapara ligjore, e për një pjesë prej tyre nuk është bërë azhurnimi në kohë. Më tutje, konstatoam se nuk kanë filluar aktivitetet për realizimin e inventarizimit nacional dhe vendosje të kadastrës së pyjeve dhe tokës pyjore, nuk është instaluar sistem i vetëm informativ si dhe nuk është miratuar plan nacional për menaxhim me zjarret në hapësirë të hapur. E theksuam nevojën për formim të komitetit nacional dhe këshillit nacional për pylltari.

Në lidhje me sigurimin e mjeteve financiare, konstatuam se një pjesë e ndërmarrjeve publike nuk kryejnë pagesë të mjeteve në Buxhetin e RM-së në bazë të reproduksionit të pyjeve dhe shitjes së masës së drurëve të konfiskuara nga prerja e paligjshme, ndërsa mjetet për reproduksion të thjeshtë nuk ndahen në llogari të veçantë.

Konstatuam më shumë gjendje si rreziqe potenciale për pyjet në RM-së, përkatësisht konsum më të madh të drurit të zjarrit nga ana e amvisërive në RM nga masa e prerë e evidentuar e drurëve, mospërputhje të të dhënave të institucioneve kompetente për prerje të paligjshme në RM.

Konstatuam koordinim, ekipim dhe pajisje të pamjaftueshme të policisë pyjore, shërbimit të rojës pyjore, shërbimit teknik dhe strukturë të pavolitshme të pleqërisë të pilotëve në njësinë ajrore, si dhe nevojë për përforcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe veprim të subjekteve kompetente për mbrojtje të pyjeve nga zjarret.

Konstatuam nevojë për përforcim të komunikimit, koordinimit, bashkëpunimit të ndërsjellë dhe veprim të subjekteve kompetente për mbrojtje të pyjeve nga zjarret.

Në pjesën e masave për mbrojtje efikase të pyjeve konstatuam se nuk është miratuar Programi i masave dhe aktiviteteve për mbledhjen e të dhënave për dëmtimin e pyjeve, nuk është vendosur regjistër i dëmtimit të pyjeve, nuk shfrytëzohet plotësisht sistemi informativ maqedonas për zjarre pyjore nga ana e të gjitha institucioneve kompetente dhe ekziston përfshirje e pamjaftueshme e institucioneve shkencore dhe profesionale nga sfera e pylltarisë. Për vendosjen e sistemit të plotë dhe efikas të mbrojtjes së pyjeve në RM, konstatuam se nuk janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme nga ana e institucioneve kompetente të cilat kanë të bëjnë me realizimin e regjistrimit dhe vendosjes së kadastrës së pyjeve dhe tokës pyjore, mbrojtjen e pyjeve nga prerja e paligjshme, mbrojtjen nga zjarret, pyllëzimin dhe ruajtjen e pyjeve, ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për miratim dhe azhurnim të dokumenteve themelore të planit për mbrojtjen e pyjeve, miratimin e rregullativës nënligjore për mbrojtjen e pyjeve, mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit, përfundimin e projekteve të filluara, realizimin e pyllëzimit në mënyrë në të cilën do të sigurohet efikasitet dhe sukses më i madh, sigurimin e mjeteve financiare plotësuese për fillim të projekteve të parapara, përforcimin e kapaciteteve kadrovike, sigurimin e mjeteve teknike materiale, komunikimin dhe koordinimin më të mirë ndërmjet institucioneve kompetente si dhe efikasitetin më të madh të institucioneve të ngarkuar për mbikëqyrje, monitorim dhe kontroll të pyjeve në RM. Realizimi i aktiviteteve të cekura do të kontribuojë për vendosjen e sistemit efikas për mbrojtjen e pyjeve në RM, me qëllim të ruajtjes së gjendjes së tyre, si dhe të mos lejohet shkatërrimi i tyre, duke e pasur parasysh rëndësinë ekologjike të pyjeve, të cilat paraqesin pjesë e pasurisë nacionale përkatësisht trashëgimi.

Për tejkalimin e gjendjeve të lartpërmendura kemi dhënë edhe rekomandime për institucionet kompetente, të njëjtat bazohen në rezultatet nga revizioni i kryer dhe janë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të efikasitetit të mbrojtjes së pyjeve në RM.

2. Efektiviteti i njësive të vetëqeverisjes lokale në planifikimin vjetor dhe realizimin e planit vjetor për furnizime publike

Qëllimi kryesor i komunave është përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmbushja e nevojave të tyre në sferën e infrastrukturës komunale, planifikimit dhe ndërtimit urbanistik, arsimit, kulturës, sportit dhe sferat tjera të jetës publike. Kompetencat e komunave realizohen përmes kryerjes së punëve publike për të cilën nevojitet angazhim dhe shfrytëzim të kapaciteteve institucionale dhe administrative, përkatësisht mjeteve financiare materiale dhe resurseve njerëzore me të cilat disponojnë komunat.

Qëllimet e planifikuara komunat i realizojnë përmes realizimit të planeve vjetore, me ndarje të marrëveshjeve për furnizim të punëve, mallrave dhe shërbimeve përmes implementimit të Ligjit për furnizime publike, për të cilat në nivel vjetor shpenzojnë nga 50 deri 60% të mjeteve të paraparë në buxhetet. Shpenzimi i mjeteve përmes marrëveshjeve të lidhura për furnizime publike, duhet të sigurojë transparencë dhe integritet të komunës si para qytetarëve, ashtu edhe para komunitetit të biznesit, shfrytëzim racional dhe efikas i mjeteve buxhetore, konkurrencë, trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë.

Auditimin e performancave e orientuam drejt shqyrtimit të mënyrës në të cilën komunat e kanë rregulluar planifikimin, zgjedhjen dhe realizimin e projekteve në programet vjetore për punë, që të japim vlerësim nëse udhëheqësia në njësitë e vetëqeverisjes lokale ka ndërmarrë aktivitete adekuate që të mundësojë planifikim vjetor efikas të furnizimeve publike dhe realizim efektiv të planit vjetor për furnizime publike.

Me revizionin u përfshinë aktivitetet gjatë realizimit të furnizimeve publike për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të të gjitha 81 komunat në Republikën e Maqedonisë duke e përfshirë edhe Qytetin e Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Me qëllim realizimin efikas dhe efektiv të aktiviteteve, komunat nevojitet të vendosin:

- strukturë organizative funksionale dhe kompetenca të defnuara;
- programe të plota, reale dhe të zbatueshme, të aprovuara nga udhëheqësia, të harmonizuara me mjetet e parapara me Buxhetin;
- procedura të qarta dhe të plota për punën, të lehta për zbatim, të azhurnuara dhe të arritshme për të gjithë të punësuarit;
- personat e përfshirë në furnizime publike të posedojnë njohuri, përvojë, aftësi, licenca, trajnime të vizituara;
- dokumentacion të qartë dhe të saktë, me kritere precize dhe specifitime teknike;

- kushte dhe konkurrencë të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë;
- aktivitetet e komisioneve për furnizime publike të jenë në kuadër të afateve të përcaktuara me planin;
- kontroll dhe vlerësim i vazhdueshëm i funksionimit të kontrolleve të brendshme, për shkak të realizimit të qëllimeve të subjektit.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendje që kanë ndikim mbi realizimin efikas dhe efektiv të aktiviteteve dhe atë:

- Komunat disponojnë me kuadër profesional, por me numër të pamjaftueshëm i cili është i përfshirë në furnizimet publike. Mjetet e kufizuara financiare janë shkak kryesorë për ekipim të pamjaftueshëm të sektorëve/seksioneve, përfshirë edhe njësitë e furnizimeve publike;
- Në komunat ku ekzistojnë procedura të vendosura dhe të zbatueshme për punë ekziston realizim më i suksesshëm i qëllimeve të planifikuara;
- Mosekzistimi i kriterëve të definuar qartë sipas të cilave do të bëhet zgjedhja e projekteve të përfshirë me programet vjetore krijon rrezik për subjektivizëm në vendimmarrje dhe favorizim të punëve të caktuara;
- Plani vjetor për furnizime publike i cili nuk përmban informata të plota për projekte konkrete dhe vlera e tyre e caktuar e vështirëson ndjekjen e realizimit të projekteve të planifikuara me programet vjetore të sektorëve, gjë që kontribuon për uljen e efektivitetit në planifikimin e nevojave të përgjithshme të komunës në tërësi.
- Gjatë planifikimit vjetor të nevojave për furnizime publike, nuk merren parasysh përvojat nga vitet paraprake në lidhje me realizimin e të ardhurave të planifikuara në buxhet, me ç'rast plani për furnizime publike nuk realizohet tërësisht ose ndërmerren obligime të cilat do të duhet të paguhen me mjete nga buxhet i vitit të ardhshëm;
- Një pjesë e madhe e komunave nuk kanë miratuar procedura me përcaktim të qartë të procedurës së planifikimit vjetor të furnizimeve publike, ndërsa në komunat ku ekzistojnë, procedurat nuk i përfshijnë të gjitha fazat e procesit të furnizimeve publike;
- Parregullsi në planifikimin e procedurave më shpesh ndodhin për shkak të:
 - √ përcaktimit të gabuar të sendit/llojit të furnizimit;
 - √ analizës së realizuar në mënyrë joadekuate të tregut;
 - √ dokumentacionit jo mjaft i qartë dhe preciz i tenderit përkatësisht kriterëve joreale, specifikimit të paplotë dhe jopreciz teknik dhe
 - √ analizës së parrealizuar të trendëve momentale të çmimeve të tregut për të vërtetuar se mjetet e planifikuara me programin dhe buxhetin janë të mjaftueshme për realizimin e furnizimit.
- Nuk është vendosur praktikë për përgatitjen dhe dorëzimin e rregullt të informatave në organet drejtuese në lidhje me realizimin e planit vjetor.

Janë dhënë rekomandime ndaj organeve drejtuese të komunave për:

- përforcim dhe përmirësim të ekipimit kadrovik të njësive për furnizime publike dhe trajnim dhe edukim të vazhdueshëm profesional;
- përforcim i prioriteteve gjatë zgjedhjes së projekteve në programet vjetore, përcaktim dhe miratim të procedurave të brendshme për procesin e furnizimeve publike, përfshirë dhe planifikimin vjetor,
- planifikimi i nevojave për furnizime publike të bëhet në kuadër të mundësive reale të komunave për realizimin e të ardhurave të planifikuara;
- azhurnim të rregullt të planit për furnizime publike në pajtim me ndryshimin e kryer të buxhetit të komunës;
- rregullim të mënyrës së ndjekjes dhe njoftimit të organeve drejtuese në komunat për realizimin te planit vjetor për furnizime publike.

Byrosë për Furnizime Publike i janë dhënë rekomandime për ndërmarrje të masave dhe aktiviteteve për rishqyrtim dhe rregullim plotësues të akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë:

- mënyrën e përcaktimit të llojit të furnizimit (mallra, shërbime dhe punë) në raste kur ekziston kombinim i furnizimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve;
- çmimin më të ulët si kriter gjatë zgjedhjes së ofertës më të volitshme dhe
- detyrimin për shpallje të vlerës së caktuar të furnizimit.

Efektet nga masat dhe aktivitetet e ndërmarra pas rekomandimeve të dhëna duhet të kontribuojnë për përmirësimin e rregullativës ligjore, mënyrë më efektive të planifikimit në komunat, e me qëllim rritjen e efektivitetit në realizimin e planit për furnizime publike dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve.

3. Cilësia e ajrit



Në pajtim me Programin vjetor për punë për vitin 2017 u bë revizion i suksesit për Cilësinë e ajrit, që u realizua me iniciativë të Gjykatës së Holandës për Revizion. Në revizionin morën pjesë 15 vende, vende nga rrethina, vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zvicra.

Koordinator i revizionit ishte Gjykata e Holandës për Revizion me Institucionin Suprem të Revizionit të Polonisë.

Me këtë revizion e përfshimë periudhën 2014-2016, në të cilën u përfshinë më shumë subjekte dhe atë në nivel qendror: Ministria

e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti i Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor dhe me pyetësor i përfshimë të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Qëllimi i revizionit ishte: „Nëse masat/aktivitetet që ndërmerren në nivel qendror dhe lokal për përmirësimin e cilësisë së ajrit janë efektive në lidhje me uljen e emisioneve të substancave ndotëse që ndikojnë në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut“.

Sferat e revizionit që u përcaktuan nga të gjitha vendet bashkërisht janë këto:

1. Ndotja e ajrit - problem me të cilin ballafaqohemi;
2. Struktura organizative e sistemit të menaxhimit me cilësinë e ajrit;
3. Korniza juridike dhe ligjore për cilësinë e ajrit;
4. Masat dhe aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
5. Financimi i masave/aktiviteteve dhe matshmëria e efekteve nga realizimi i tyre;
6. Sistemi i ndjekjes dhe njoftimi për cilësinë e ajrit.

Çdo vend kishte mundësi të punojë në të gjitha sferat ose në sferat të cilat do t'i caktojë vet. ISR-ja e Republikës së Maqedonisë i përfshiu të gjitha sferat e përcaktuara.

Gjendjet të cilat i konstatuam sipas sferave janë këto:

- Substancat më kritike ndotëse që ndikojnë në cilësinë e ajrit në RM janë grimcat e suspenduara (PM10 и PM2.5);
- Përqendrimet vjetore mesatare të PM10 e tejkalojnë vlerën kufitare vjetore (40 µg/m³) në të gjitha stacionit monitoruese, të vendosura në vende urbane nga viti 2005 e këndej, ndërsa më të larta janë matur në Tetovë dhe Shkup (Lisiçe), të cilat tejkalojnë 120 µg/m³;
- Përqendrimet e (PM2.5) maten në dy stacione monitoruese në Shkup, ndërsa vlera e tyre vjetore mesatare është dy herë më e lartë se vlera kufitare.

Vlerësimi i cilësisë së ajrit ambiental nuk është i plotë për arsye se:

- Të dhënat e emisioneve në burimet stacionare të ndotjes nuk janë të plota;
- Nuk merren parasysh të dhënat për sasitë e misioneve të substancave ndotëse nga burimet joprodhuese;
- Qasja e dobët në të dhënat hyrëse cilësore e kufizon aplikimin e modeleve shpërndarëse për vlerësim të cilësisë së ajrit.

Megjithëse struktura organizative e sistemit të menaxhimit me cilësinë e ajrit është e definuar qartë në rregullativën ligjore, janë konstatuar dobësi të caktuara dhe si vijojnë:

- Struktura e mbikëqyrjes inspektuese në mjedisin jetësor nuk korrespondon në tërësi me kërkesat që dalin nga e drejta e BE-së, me ç'rast në vitin 2016 është përpiluar një Ligj i ri për inspektim të mjedisit jetësor;
- Kapaciteti administrativ dhe teknik i institucioneve kompetente është i pamjaftueshëm në nivel qendror, e veçanërisht në nivel lokal, në aspekt të ekipimit kadrovik, pajisjes, dhe mjeteve financiare;
- RM-ja nuk u nënshtrohet sanksioneve nga ana e BE-së, as që ekzistojnë sanksione në nivel qendror/lokal për mosarritje të qëllimeve të përcaktuara me politikat për cilësi të ajrit;
- Matje të bartjes tejkuftare të substancave ndotëse bëhen vetëm në një stacion matës;
- Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunat nuk kanë vendosur bashkëpunim me organet kompetente nga shtetet fqinje;
- Korniza juridike dhe strategjike me të cilën rregullohet cilësia e ajrit ambiental në RM, është harmonizuar me BE Direktivat nga sfera e cilësisë së ajrit ambiental;
- Ndryshimet të përfshirë në Direktivën e re 2015/1480 të Komisionit (BE), e që kanë të bëjnë me anekset nga Direktiva 2004/107/EC dhe Direktiva 2008/50/KE, si dhe ndryshimet e Direktivës 2001/81/KE ende nuk janë transponuar në legjislacionin nacional;
- Nuk janë definuar pragjet e informimit dhe alarmimit për grimcat PM10, për shkak të vërejtjeve dhe kërkesave të caktuara për korigjime nga ana e sektorit joqeveritar.

Megjithëse janë realizuar masa të caktuara për mbrojtje të ajrit ambiental, të njëjtat nuk mjaftojnë për arritje të rezultateve të kënaqshme në lidhje me uljen e ndotjes:

- Për Programin për investim në mjedisin jetësor për 2014, 2015 dhe 2016 ndahen mjete buxhetore në shumë të njëjta dhe në asnjë vit nuk janë ndarë mjete për projekte që janë të lidhura me mediumin ajër;
- Mjetet për realizim të Programit vjetor për punën e SMASHCA nuk janë të mjaftueshme për servisim, blerje të pjesëve rezerve të stacioneve matëse, dislokim të stacioneve monitoruese ekzistuese, blerje të pajisjes së laboratorit dhe analizave kimike, akreditim të Laboratorit Qendror dhe të kalibrimit;

■ Sipas të dhënave nga ESHS, investimet dhe shpenzimet për mbrojtje të ajrit marrin pjesë me 13% për 2014 dhe 2015, ndërsa me 6% në 2016, nga investimet dhe shpenzimet e përgjithshme për mjedis jetësor. Prej tyre më së shumti janë bërë në industrinë dhe prodhuesit e specializuar afro 83 - 96%, ndërsa në sektorët tjerë të pjesëmarrjes aktive ekonomike përqindja është e vogël dhe lëviz prej 4 -17%.

Në lidhje me plotësinë e të dhënave dhe raporteve nga monitorimi i cilësisë së ajrit është konstatuar kjo:

■ Në periudhën 2014-2016, prej 17 stacioneve monitoruese, 3 nuk janë në funksion, te të tjerët, një pjesë e parametrave nuk maten, e për një pjesë nuk është siguruar mbulimi minimal me të dhënat;

■ Përveç për vitin 2014, në vitet tjera lëndë të revizionit përqendrimet e benzenit nuk maten rregullisht, ndërsa për metalet e rënda dhe hidrokarburet aromatike realizohen fushata matëse indikative që nuk janë mjaft reprezentativë;

■ Një pjesë e instalimeve nuk dorëzojnë raporte nga matjet e kryera në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor dhe Qendrën Informativë të Mjedisit Jetësor të Maqedonisë;

■ Është vendosur sistem informativ për cilësinë e ajrit AIRVIRO, i cili është lidhur me ueb portalin për cilësi të ajrit. Edhe pse baza e të dhënave është dizajnuar me vëllim të madh të të dhënave, mungojnë të dhëna nga burime tjera për vlerësim të cilësisë së ajrit ambiental, për shkak të së cilës e njëjta nuk është e plotë;

■ Kadastra e vendosur e ndotësve të ajrit nuk është e plotë për shkak se mungojnë të dhëna nga burime joprodhuese të emisioneve dhe të dhëna nga matjet e kryera të një pjesë të burimeve prodhuese të emisioneve.

Për tejkalimin e dobësive të konstatuara, revizioni u dha rekomandime institucioneve kompetente, organeve dhe trupave me qëllim tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

4. Partneriteti privato publik



Realizuar revizion të suksesit me temë "Partneriteti privato publik në nivel lokal", me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: "Nëse korniza ligjore dhe struktura institucionale sigurojnë vendosje të suksesshme të partneritetit privat publik te njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe cilat janë efektet nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet partnerit privat dhe publik", si dhe dhënie të rekomandimeve që do të jenë të orientuara drejt vendosjes së sistemit efikas të partneritetit privat publik dhe rritje të efekteve nga i njëjti.

Partneriteti privat publik paraqet bashkëpunim afatmesëm, e më shpesh afatgjatë ndërmjet sektorit privat dhe publik, në kuadër të të cilit me kombinim të përvojave dhe kompetencës së të dyja sektorëve, zgjidhen në mënyrë më të suksesshme problemet në nivel nacional, rajonal dhe lokal.

Vendosja e partneriteteve të këtyre dy sektorëve udhëhiqet nga logjika se rezultate më të mira do të realizohen me bashkëpunim të përbashkët, sesa kur veprohet individualisht. Leverdia e PPP, në raport me sigurimin tradicional të të mirave dhe shërbimeve publike, duhet të jetë rezultat i zgjidhjes projektuese të dizajnuar në mënyrë cilësore, strukturës financiare dhe menaxhimit të përbashkët të projektit.

Revizioni i suksesit e përfshin periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2017, me vështirim të veçantë në vendosjen e partneritetit privat publik te njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Aktivitetet e revizorit u orientuan në sferat vijuese:

- Rregullativa ligjore, kompetencat dhe koordinimi i institucioneve;
- Zbatimi i procedurave për vendosje të NPP nga ana e komunave;
- Efektet nga implementimi i marrëveshjeve për NPP.

Me këtë revizion i përfshimë partneritetet private publike te njësitë e vetëqeverisjes lokale me partneritetet private në sferën e ndriçimit publik, objekteve afariste administrative dhe ndërtimit të objekteve për sport.

Me auditimin e performancave u përfshinë:

- Ministria e Ekonomisë;
- Komuna e Gjorgje Petrovit dhe Kriva Pallankës (për ndërtim të objektit afarist administrativ);
- Komuna e Çairit, Shën Nikollës dhe Studeniçanit (në pjesën e ndriçimit rrugor);
- Komuna e Aerodromit (për ndërtim të kompleksit sportiv);
- Komuna e Tetovës dhe Gazi Babës (për ndërtim të fushës së futbollit).

Me revizionin konstatuam se struktura institucionale ekzistuese e partneritetit privat publik në Republikën e Maqedonisë dhe implementimi praktik i modeleve të partneritetit privat publik, pjesërisht sigurojnë realizim të suksesshëm të projekteve.

Me qëllim të vendosjes së implementimit të suksesshëm të projekteve me partneritet privat publik nevojitet përforcim të kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe lokal. Nevojitet qasje sistemore e të gjitha institucioneve të përfshirë në procesin e zbatimit të procedurave për partneritet privat publik dhe veprim të tyre në pajtim me kompetencat dhe atë: revidim të Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik, formim të institucionit/trupit i cili do të jetë përgjegjës për dhënie të mendimit për ngritje të procedurës deri në realizimin e marrëveshjes për partneritet privat publik dhe për përpilimin dhe miratimin e dokumentit strategjik si bazë për drejtime strategjike për realizim të suksesshëm të partneritetit privat publik.

Enti shtetëror për revizion në vitin 2017, realizoi bashkëpunim të pasur ndërkombëtar në nivel bilateral dhe multilateral. Pjesëmarrja në revizionet kooperative nga sfera e furnizimit publik dhe mjedisit jetësor me institucionet e larta revizore nga Bashkimi Evropian dhe rajoni, kontribuoi për avancim në nivel profesional të kuadrit të Entit Shtetëror për Revizion dhe për cilësinë e revizioneve të suksesit, gjë që ishte një prej prioriteteve kryesore të institucionit në periudhën e kaluar.

Pas realizimit të suksesshëm të projektit për revizion paralel të suksesit 1 nga sfera e efikasitetit energjetik (2015) në të cilin morën pjesë institucionet e larta revizore të vendeve nga rrjeti - rajoni, ISR-ja e Suedisë inicoi projekt të ri, revizion kooperativ të suksesit 2 nga sfera e furnizimeve publike. Projekti filloi në vitin 2016 me mbështetje të ISR-së së Suedisë dhe Gjykatës Evropiane e Revizorëve dhe zgjati deri në fund të vitit 2017.

Pas përfundimit të tij u përpilua një raport përmbledhës në të cilin u prezantuan konstatimet kryesore dhe konkluzionet kryesore nga raportet nacionale të revizorëve të pjesëmarrësve të ISR-së.

Në vitin 2017 Enti shtetëror i revizionit mori pjesë në revizionin kooperativ me temë cilësia e ajrit, të realizuar në koordinim me ISR-në e Holandës dhe ISR-në e Estonisë, si kryesues me grupin e punës të EUROSAL për mjedis jetësor.

Përfitimet nga bashkëpunimi në revizionet kooperative janë të shumëfishta. Në veçanti do ta theksojmë mundësinë për mbindërtim profesional të revizorëve pjesëmarrës përmes aktiviteteve peer-to-peer, qasjes fleksibile, kontrollit të përvojave personale dhe shfrytëzimit të përvojave nga pjesëmarrësit tjerë dhe forcimit të mirëbesimit në kapacitetet personale për kryerje të revizionit të suksesit.

Këmbimi i njohurive dhe përvojave të reja nga sfera e revizionit shtetëror me kolegët nga ISR-të tjera u zhvillua përmes formave standarde të bashkëpunimit dhe kryesisht në koordinim të INTINTOSAI² dhe EUROSAL³. Kontributi i Entit shtetëror të revizionit në punën e grupeve të punës dhe trupave të formuara për realizimin e qëllimeve strategjike të EUROSAL 2011-2017 dhe në promovimin e etikës dhe integritetit të ISR dhe institucionet në administratën publike, vazhdoi me intensitet të njëjtë edhe në vitin 2017.

Pjesëmarrjet e të punësuarve në Entin shtetëror të revizionit në ngjarje ndërkombëtare për edukim dhe mbindërtim u zhvilluan në sferat vijuese: implementimi i ISSAI⁴ për revizion të suksesit, revizion të brendshëm, ruajtje të cilësisë së ujit, forcim të integritetit të ISR dhe luftë kundër korrupsionit, menaxhim me borxhin e brendshëm, realizim të revizioneve kooperative, revizion të komunave dhe revizion të mjedisit jetësor.

² Organizata ndërkombëtare e institucioneve të larta të revizionit – ESHR është anëtare nga viti 2001

³ Organizata evropiane e institucioneve të larta të revizionit- ESHR është anëtare nga viti 2002

⁴ Standardet ndërkombëtare të institucioneve të larta të revizionit

Enti shtetëror i revizionit është veteran sipas anëtarësisë në rrjetin e ISR të vendeve kandidate dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në BE dhe në Gjykatën Evropiane të Revizorëve. Hymë në dekadën e dytë të pjesëmarrjes sonë aktive dhe kontributit në realizimin e aktiviteteve të rrjetit qëllimi i të cilit është përgatitja e strukturave të revizorëve në vendet që përgatiten për anëtarësim në familjen evropiane.

Statusi i kandidatit i Republikës së Maqedonisë për pranim në Bashkimin Evropian, i fituar në fund të vitit 2005, Entit Shtetëror i Revizionit i mundësoi që të marrë pjesë rregullisht, në cilësi të vëzhguesit aktiv, në mbledhjet e Komitetit kontaktues dhe të jetë hap me ngjarjet më të reja dhe me sfidat me të cilat ballafaqohen shefat e ISR nga Bashkimi Evropian gjatë kryerjes së funksionit të revizorëve.

Aktivitetet në kuadër të EUROSAL, INTOSAI dhe organizatat tjera



Anëtarësimin në grupet e punës të EUROSAL për mjedis jetësor nga viti 2002 dhe për IT nga viti 2005, Enti Shtetëror i Revizionit e mban me pjesëmarrje të vazhdueshme dhe aktive në punën tonë.

Viti i katërt me radhë që marrim pjesë

në aktivitetet e grupit operativ të EUROSAL për revizion dhe etikë, të udhëhequr nga ISR të Portugalisë që punon në forcimin e integritetit dhe etikës të institucionet supreme të revizioneve dhe institucionet e administratës publike.

